

91  
L 91

BIBLIOTEKA E NXËNËSIT

**LEXIME  
GJEOGRAFIKE**  
**MBI LUNDËRTARËT  
E MËDHENJ**



TIRANË, 1966

91  
L 97

MINISTRIA E ARËSIMIT DHE E KULTURËS

Drejtoria e Studimeve dhe Botimeve Shkollore

LIBRARI E SHTABIT  
KALIMASH

2285F

LUNDËRTARËT  
E  
MËDHENJ

*[Handwritten signature]*

TIRANË, 1966

*Nxënësit e klasave të pesta dhe të gjashta qëndrojnë sot pa ndrojtje dhe flasin lirisht përpara globeve dhe hartave të hemisferave mbi kontinentet dhe pjesët e ndryshme të botës. Ata flasin rrjedhshëm dhe me lehtësi mbi vijën bregdetare të Afrikës, Australisë, Amerikës Veriore e Jugore; përshkruajnë Ultësirën e Amazonës dhe rrafshnaltën e Pamirit; tregojnë mbi burimet e Kongos dhe ujëvaren e Zambesit etj.*

*Nxënësit jo vetëm që i përshkruajnë, por në mendjen e tyre të njomë, në imagjinatën e tyre ndërtojnë parafytyrime të këtyre vendeve të bazuara në hartat gjeografike, tregime, lexime, filma, figura, etj.*

*Por nuk ka qenë gjithnjë kështu.*

*Akoma dy shekuj më parë në hartat e botës ka pasur shumë «njolla të bardha». Deri në mbarim të shek. XVIII në hartat gjeografike të lëmshit të dheut nuk ishin përcaktuar saktë konturet e vijës bregdetare të Antarktidës, e veriut ekstrem të Amerikës, pjesa jugore e Australisë si dhe shumë ishuj të Arktikut dhe oqeanit Paqësor. Jo vetëm kaq, por hapësira të mëdha brenda kontinenteve kishin mbetur akoma si «njolla të bardha» ose paraqiteshin në harta në mënyrë skematike dhe*

shpesh të gabuara. Nuk ishte zgjidhur akoma çështja se ku buron Nili, asnjë nuk kishte depërtuar në pyjet tropikale, nuk ishte ngjitur akoma njeri në majat vullkanike të Kordiljereve ose nuk kishte kaluar njeri në shkretëtirat e Azisë së mesme etj.

Sikur të futemi më tutje në thellësinë e shekujve, njohuritë mbi botën kanë qenë shumë të kufizuara. Dihet p.sh. se deri në fund të shek. XV akoma nuk njihej «Bota e Re».

Nxënësit e shkollave 8 e 12 vjeçare nëpërmjet leximeve të bukura të broshurave «Lundërtarët e mëdhenj» do të mësojnë se me sa mundim, heroizëm, këmbëngulje u arrit që të njihet bota, të zhdukeshin «njollat e bardha». Ata do të shikojnë vendosmërinë, vullnetin, luftën kundër paragjykimeve fetare të këtyre zbuluesve.

Pavarësisht nga fakti se kush e nxiti dëshirën e këtij ose atij lundërtari, kush ishte motivi që e vuri në lëvizje këtë ose atë zbulues, rezultatet e arritura nga ekspeditat e ndryshme janë një kontribut i madh për shkencën gjeografike.

Kjo është njera anë e zbulimeve gjeografike.

Ana tjetër është ajo e pushtimeve të tokave të zbuluara nga kolonizatorët europianë, shtypja e shfrytëzimi i popujve vendas – indigjenëve.

Po e ilustrim më me një shembëll.

Disa vjet pas zbulimit të Kolombit pushtuesit spanjollë «konkuistadorët», duke bërë barbarizma të mëdha, duke përdorur të gjitha mjetet e dhunës, të tradhëtisë dhe mashtrimit, pushtuan tokat më të pasura dhe më të populluara të «Botës së Re». Kolonizatorët europianë, këta njerëz «të qytetëruar», brenda një kohe shumë të shkurtër zhdukën popullsinë vendase ose e dëbuan nga zonat prodhuese.

Një pjesë e vogël që mbeti, u kthye në tokat e tyre, në shtëpitë e tyre ku kishin jetuar e punuar gjyshërit e stërgjyshërit e tyre, në skllëvër e bujkrrobër. Nga puna e rëndë në minierat ose plantacionet e kolonizatorëve edhe kjo popullsi e pakët që i shpëtoi rrebeshit të parë filloi të zhduket. Për të plotësuar nevojën për krah pune për t'u pasuruar me çdo kusht, kolonizatorët europianë kaluan në një metodë të re, në atë të skllavërisë. Filloi gjuetia e zezakëve në Afrikë, zënia e tyre dhe transportimi në masë nëpër hambarët e anijeve për në Amerikë. Kthehet pra kështu skllavëria në formën e saj më të egër, si dikur në periudhën antike.

Skllëvërit zezakë i nënshtruan vuajtjes së dyfishtë: shtypjes e shfrytëzimit në punë të rënda dhe shtypjes e shfrytëzimit racial, urrejtjes dhe përbuzjes për ngjyrën e tyre të zezë.

Megjithëse koha ka rrjedhur, bota ka ndryshuar, popujt janë zgjuar nga idetë e marksizëm-leninizmit dhe kundër dallimit racial është bërë dhe bëhet një luftë e vendosur revolucionare; mjerrisht edhe sot ne të gjithë jemi dëshmitarë të diskriminacionit racial, persekutimit të popujve me ngjyrë nga ana e atyre që e quajnë veten «të qytetëruar» dhe «racë superiore» kundrejt zezakëve ose siç i quajnë ata «njerëz me aftësi të kufizuar».

Nëpërmjet leximeve të kësaj broshure, nxënësit do të shikojnë se qysh në atë kohë njerëz përparimtarë kanë ngritur zërin e tyre të protestës kundër shtypjes e skllavërisë, por zëri i tyre mbeti dhe do të mbetej si zëri në shkretëtirë. Do të duhet akoma luftë revolucionare, përpjekje, sakrifica për të shpëtuar një herë e përgjithmonë nga shfrytëzimi i njeriut nga njeriu, nga shtypja raciale.

*Nga kjo nxjerrim si konkluzion së pari anën pozitive të zbulimeve. Zbulimet ndihmuan për njohjen e botës si: Amerikës, Australisë, brendësisë së Afrikës dhe shumë vendeve të globit tokësor. Të gjitha këto u arritën në saje të këmbënguljes, vendosmërisë, guximit dhe sakrificave që treguan zbuluesit e mëdhenj.*

*Së dyti del ana negative e zbulimeve: shfrytëzimi nga ana e kolonizatorëve europian i këtyre zbulimeve për të pushtuar, shfrytëzuar e grabitur popujt e këtyre vendeve të pasura e deri në atë kohë të panjohura. Del gjithashtu nevoja e një organizimi të fortë të forcave revolucionare në vendet që janë akoma të varura ose gjysëm të varura nga imperialistët dhe lufta pa kompromise e deri në fund për liri, pavarësi e demokraci.*

## MARKO POLO

Një ndër përrallat arabe është edhe ajo që bën fjalë për aventurat e jashtëzakonshme të tregëtarit Sindbad detari. Ky tregëtar cilësohet si njëri trim, i cili ka bërë udhëtime të gjata e të largëta me anije me vela nëpër dete me plot tallaze e stuhira. Gjithashtu bëhet fjalë se këmba e tij shkeli në male shumë të larta, sesi luftoi me një vigan, pa zogun e tmerrshëm ruh, që ngre në ajër dhe fut në folenë e tij një dem të gjallë. Kjo është një përrallë shumë e vjetër, të cilën akoma edhe sot e lexojnë me interes të madh. Bile 700–800 vjet më parë në Europën mesjetare njerëzit besonin me bindje se në vendet e largëta të Lindjes ekziston një farë dragoi i pangopur, zogu i tmerrshëm ruh si dhe shumë mrekullira të tjera po aq të pabesueshme. Në ato kohëra shumë të largëta, europianët pothuajse nuk dinin asgjë rreth qyteteve të pasura të Kinës dhe të Indisë, për xhunglat me plot kënetë dhe mbi pllajatat e larta e të mëdha të Azisë, mbi fushat e mëdha bujqësore, nëpër të cilat rrjedhin lumejt e mëdhenj Jance dhe Huanhe.

Në Europë çmoheshin shumë prodhimet e vendeve të lindjes, si beharnat (kanella, rrënjët e karafilave, piperi), që i japin një shije të veçantë

gjellës; gurët e çmueshëm, fildishi dhe artikujt e punuar me të. Gjenova dhe Venediku, që ishin në atë kohë qytete të mëdha, tregëtinë me Lindjen e bënin me anën e tregëtarëve arabë.

Tregëtarët arabë, kur sillnin mallra të përtejdetit në skelat europiane, tregonin për vendet e largëta të kontinentit aziatik. Kështu Europa fitoi disa njohuri gjeografike mbi vendet deri në këtë kohë të panjohura: Kinën, Indinë dhe mbi ishujt e arqipelagut të Malezisë.

Në shek. XIII bëhet fjalë për disa përshkrime të vendeve të Lindjes, të shkruara nga udhëtarë europianë. Me anën e këtyre përshkrimeve Europa fillon të njihet me vendet e panjohura të Azisë së largët, me kulturën e shumanëshme të popujve të saj si dhe me natyrën e saj karakteristike. Nga përshkrimet më interesante dhe më të shquara është ai i udhëtarit Marko Polo me origjinë prej Venediku.

I ati, një tregëtar venedikas i zoti, bashkë me të vëllanë e tij bëri tregëti gadi 14 vjet me vendet e Lindjes. Vëllezërit Polo dy vjet mbas kthimit në Venedik u nisën për në Lindje, duke marrë me vete kësaj radhe edhe Markon e ri.

Kështu filluan vjetët e endjeve të venedikasve. Në brigjet e Azisë Marko Polo shkoi nëpërmjet detit Mesdhe. Duke kaluar përmes luginës së Tigris arriti në Bagdad dhe në Basra – port detar në gjirin e Persisë. Nga këtu Marko Polo, vazhdoi përsëri udhëtimin e tij me anije dhe era e mbarë e solli deri në Ormuz. Prej këndej, Marko Polo me karvanet e tij përshkoi krejt Azinë qendrore, duke kaluar nëpër rrugë të gjata dhe me plot vështirësira. Ai jetoi për mjaft kohë në Mongoli dhe në Kinë.






Fig. 1. Harta e udhëtimitve të Marko Polos.

Duke u kthyer për në Venedik me një anije kineze, Marko Polo përshkoi tej për tej oqeanin Indian. Gjashtë muaj zgjati ky lundrim me plot përipetira. Nga 600 vetë që ishin në fillim, në fund të lundrimit mbetën gjallë pak veta. Gjatë këtij lundrimi Marko Polo pa Sumatrën, Ceilonin dhe brigjet e Industanit.

Prej gjirit të Persisë, duke kaluar nëpër shkretëtira e male dhe duke hipur përsëri në anije, më në fund ai arriti në Venedik po me anën e detit Mesdhe. Marko Polo kaloi rreth 25 vjet larg qytetit të Lindjes. Pak kohë pas kthimit të tij Marko Polo provoi edhe një aventurë, — aventurën e fundit në jetën e tij. Atdheu i tij — Venediku dhe qyteti tjetër i pasur tregëtar — Gjenova ishin në luftë për vend të parë në tregëti. Në atë kohë tregëtarët venedikas dhe gjenovezë dinin të përdornin alebardat<sup>1)</sup>, shpatat dhe grepat e abordazhit<sup>2)</sup> po aq mirë sa dhe kandarin dhe librat e llogarive. Në një betejë detare mori pjesë edhe Marko Polo. Venedikasit u thyen, ai ra rob i gjenovezëve dhe u burgos. Pas ca kohe Marko Polo u kthye në Venedikun e tij dhe, mbas 25 vjetëve që jetoi në qetësi dhe gëzim vdiq në vitin 1324.

Marko Polo gjatë kohës që ishte i burgosur në Gjenovë, hartoi librin që më vonë u bë përmendore e pavdekëshme e udhëtimit të tij. Dalja e këtij libri bëri bujë të madhe. Nën ndikimin e Marko Polos atë e shkroi në burg Rustičanoja me origjinë prej Pize, shkrimtar i romaneve të kalor-sisë, që kishte rënë po ashtu rob i gjenovezëve si Marko Polo.

---

1. armë e vjetër në formë hushte

2. çengel për të kapur anijet.

Në burgun tërë lagështi dhe pa dritë Marko Polo tregoi udhëtimet e tij, të cilat i shkroi faqe për faqe Rusticanoja. Mbas çdo pjese të kujtimeve të tij, Marko Polo shtonte në fund: «Po e lemë këtë vend, tani fillojmë të tregojmë me radhë për vende të tjera. Urdhëroni e dëgjoni». Kështu Rusticanoja fillonte të shkruante kapitullin tjetër të ri.

Gjatë udhëtimit prej Venedikut në Mongoli Marko Polo kaloi nëpër «Çatinë e botës» — Pamirin. Duke kujtuar këtë, ai diktoi: «Shkon në verilindje gjithënjë nëpër male dhe ngjitesh në vendin më të lartë në botë, siç thonë njerëzit. Në këtë vend të lartë midis dy maleve gjendet një rrafshinë, nëpër të cilën kalon një lum i mrekullueshëm. Kullota nga më të mirat në botë gjenden këtu; bagëtia më e dobët majmet këtu brenda dhjetë ditëve. Ka shumë kafshë të egra. Jetojnë desh të egër të mëdhenj... Sa më shumë të ngjitet njeriu në Pamir aq më e ashpër bëhet natyra... gjatë gjithë kohës nuk sheh as banesa, as bar; ushqimin duhet ta marrish me vete. Shpezë nuk ka në këtë vend për shkak të lartësisë dhe të ftohtit. Nga lartësia dhe të ftohtit e madh as zjarri nuk ndriçonte shumë dhe ngjyrën nuk e kishte si në vendet e tjera, as ushqimi nuk tretesh aq mirë.»

Për udhëtimin nëpër shkretëtirën e Gobit udhëtari tregon: «Dhe kjo shkretëtirë, po ju them, është e madhe: as për një vit nuk mund ta përshkosh për së gjati; bile edhe atje ku është e ngushtë, me zor mund ta përshkosh për një muaj. Kudo male, rërë dhe lugina, dhe në asnjë vend ushqim.»

Në kapitujt më interesantë hyjnë ata që bëjnë fjalë për Kinën. Marko Polo flet me admirim të madh për qytetet kineze. Tregëtari mesjetar eu-

ropian nuk ka ditur të përshkruajë në mënyrë të plotë çdo gjë që ka parë në Kinë, meqenëse disa gjëra i ka lënë në heshtje, duke menduar se bashkatdhetarët e tij nuk do të ishin në gjendje të kuptonin kulturën e atëherëshme kineze, e cila ia kalonte shumë kulturës së Europës mesjetare. Për shembëll, Marko Polo nuk bën fjalë për shtypjen e librave në Kinë, që nuk njihej akoma në Europën e asaj kohe. Por edhe ato gjëra, për të cilat tregon udhëtari, u hapi europianëve një botë të re të mrekullueshme.

«Ju folëm për shumë krahina, i lemë tani të gjitha këto dhe fillojmë mbi Indinë dhe mbi të gjitha mrekullitë e atjeshme», — kështu fillon në librin e venedikasit kapitulli i ri. Udhëtari tregon se në Indi vetëm tre muaj në vit bien shirat, qershor, korrik, gusht. Midis të tjerave Marko Polo tregon se populli indian si ushqim kryesor ka orizin. Në mënyrë të gjallë dhe bukur përshkruan zakonet e ndryshme të banorëve në Indi.

Në librin e Marko Polos bëhet fjalë edhe për Japoninë, Javën dhe Sumatrën, Ceilonin, Madagaskarin dhe për shumë vende të tjera të mëdha e të vogla si dhe për mjaft ishuj.

Marko Polo e përfytyroi më mirë se cilido nga europianët e kohës së tij pamjen e Tokës. Megjithatë idetë gjeografike të tij ishin akoma shumë larg realitetit. Veriu i Azisë i dukej atij vend i errësirës së përjetëshme. «Në veri... gjendet vendi i errtë; atje gjithmonë është errësirë, nuk ka as diell, as hënë, as yje, d.m.th. gjithnjë errësirë, si tek ne në ngrysje». Mjaft gjëra të gabuara ka në tregimin e Marko Polos edhe mbi Lindjen e Azisë. Ai Japoninë e parafytyronte si vend me rezerva të pashte-

ruara floriri: «Po ju them se ari tek ata është me bollëk të madh».

Në fillim të tregimit të tij udhëtari shkruan: «Cilido që do ta lexojë këtë libër ose do të dëgjojë rreth brendisë të tij, le t'i besojë, mbasi çdo gjë në të është e vërtetë». Por njerëzit e asaj kohe nuk i besuan venedikasit. Atë e konsideronin tregues trillimesh të ndryshme. Duhet vënë në dukje se në tregimin e tij udhëtari ka futur aty këtu edhe legjenda fantastike, të cilat i kishte dëgjuar gjatë udhëtimeve shumëvjeçare. Kështu Marko Polo flet për zogun ruh — shpezë me trup të madh dhe shumë i fuqishëm, që fluturon në ajër me elefantin në thonj, pastaj e lëshon në tokë, ku copëtohet dhe zogu e kukit, e shqyen dhe ushqehet me të».

Bashkatdhetarët e Marko Polos mund t'i besonin në atë kohë kësaj legjende. Në hartat gjeografike të mesjetës që gjenden edhe sot, janë vizatuar figura shpezësh dhe egërsirash po kaq fantastike. Gjithashtu trillime iu dukeshin tregimet krejt reale të venedikasit: se në Kinë i ngrohin banesat me «gur të zi» dhe se zjarri i këtij guri është më i fortë se ai i druve, se në oqeanin Indian lundërtari nuk mund të shohi në qiell Yllin polar, mbasi në këto vende fshihet pas horizontit. Por koha kaloi... Udhëtarë të tjerë sollën njohuri të reja, që vërtetuan tregimet e venedikasit në lidhje me vendet, që i kishte parë me sytë e tij. Në bazë të librit të Marko Polos kartografët shënuan në harta detet, lumejt dhe qytetet e përmendura në të. Dyqind vjet pas botimit të këtij libri atë e lexoi me vemendje, rrjesht pas rrjeshti, lundërtari i njohur gjenovez Kristofor Kolombi. Është ruajtur deri më sot ekzemplari i librit me shënimet e bëra prej tij. Kështuqë libri i Marko Polos vazhdoi jetën

e tij jo si përmbledhje përrallash, por si burim i sigurt njohurish. Udhëtimi i tij ka qenë një nga udhëtimet më të shquara në historinë shumëshekullore të njohjes së Tokës.

## HEROIZMI I KOLOMBIT

Zbulimi i skajit jugor të Afrikës dhe i rrugës detare për Indi dhe Kinë nga ana e Portugalisë, ngjalli tek shtetet e tjerë dëshirën për udhëtime detare në vendet e pasura, legjendare të Lindjes. Spanja nuk donte të pajtohej me forcimin e fqinjës së saj — Portugalisë, fuqia e së cilës mund të çonte në robërimin e vetë Spanjës.

Qeveria spanjolle filloi të kërkojë rrugë të reja në Lindje. Tregëtarët dhe dijetarët e atëhershëm i paraqitën qeverisë projekte të ndryshme, por të gjitha ishin të perealizueshme.

Në këtë kohë disa dijetarë që kishin studiuar veprat e shkrimtarëve të lashtë, arritën në përfundimin se Toka ka formë rruzulli. Domethënë, po të lundrosh me anije gjithënjë nga perëndimi, nëpër oqeanin Atlantik, më në fund do të arrish në Azinë Lindore. Bile, ata thonin se oqeani nganjëherë sillte nga vende të panjohura në brigjet e Europës trungje drujshe, mbi të cilët shpesh herë gjendeshin gjurma përpunimi të drurit nga dora e njeriut.

Astronomi italian Toskaneli përpiloi një hartë të re të botës. Në përfundim të oqeanit Atlantik, ai paraqiti brigjet lindore të Azisë dhe në oqean një numër të madh ishujsh, në të cilët detarët mund të pushonin gjatë rrugës. Toskaneli, midis

këtyre ishujve, shënoi në hartë ishullin e madh të Çipangos (Japonisë).

Klerikët, besnikët e kishës, ngulnin këmbë si gjithnjë së Toka nuk është e rumbullaktë, prandaj po të lundrosh në perëndim do të thotë të shkosh drejt rrezikut të vërtetë.

Megjithëse udhëtimi në vendet e Lindjes ishte shumë tërheqës, asnjëri nga spanjollët nuk kishte guxim të nisej për këtë udhëtim të panjohur e të rrezikshëm.

Por ja që në Spanjë vjen një lundërtar me origjinë italiane (Gjenovë) që kishte lundruar më parë në flotën portogezë. Ky ishte Kristofor Kolombi. Ai i paraqiti mbretit të Spanjës projektin e tij — të shkonte me anije në Azi me anën e oqeanit Atlantik. Mbreti duhej të jepte anijet, t'i paiste këto me ushqime dhe njerëz.

Rreth projektit të Kolombit filloi një luftë e gjatë. Nga njëra anë qeverisë i pëlqente «të provonte fatin», nga ana tjetër atë e frikësonin murgjit, të cilët duke çpallur Kolombin të çmendur, paraqitnin argumenta nga «shkrimi i shenjtë» kundër projektit të tij. Për disa vjet qeveritarët e Spanjës ngurruan dhe më në fund vendosën të ndihmonin Kolombin që të ndërmernte ekspeditën.

Më 3 gusht 1492 prej qytetit Pallos u nisën tri anije të vogëla — karavela «Nina», «Pinta» dhe «Santa-Maria», më e gjata nga të cilat ishte 20 metra. Ekipazhi i anijeve përbëhej në pjesën më të madhe prej keqëbërësish të dënuar. Tri anijet kishin gjithësejt 90 detarë.

Oqeani iu duk lundërtarëve i pafund. Kishin kaluar 33 ditë që kur ekspedita ishte larguar prej ishujve Kanarie, ndërsa tokë nuk shihej gjëkund. Nëpër anije filloi rebelimi. Për fat të Kolombit më




Fig. 2. Harta e lundrimeve të Kristofor Kolombit.



12 tetor 1492 u dëgjua britma e pritur për aq kohë: «Toka! Anijet iu afruan një ishulli të ultë, të mbuluar me pyll të dendur tropikal. Ishulli ishte i banuar. Në të jetonin njerëz me lëkurë ngjyrë të kuqebakri. Ky ishte ishulli Guanahani nga grupi i ishujve Bahama. Kolombi i dha emrin San-Salvador. Pas një kohe të shkurtë ai zbuloi dhe shumë ishuj të tjerë. Më të madhin midis tyre, që gjendej në jugperëndim të ishujve Bahama — Kubën, Kolombi e konsideroi si gadishull të Azisë. Prej ishullit të Kubës Kolombi shkoi në juglindje dhe në fillim të dhjetorit arriti në ishullin Haiti, në brigjet e të cilat shikohen «luginat më të bukura në botë». Këtij ishulli Kolombi i dha emrin Espanjola (ishull spanjoll). Por mbas një kohe të shkurtë Kolombit i ndodhi një fatkeqësi. Anija «Santa-Maria» u fut në cektesirë, prej nga nuk qe e mundur ta nxjerrnin. Një pjesë e ekipazhit (39 spanjollë — u detyruan të qëndrojnë në Espanjolë në një kasolle të ndërtuara prej anijes së zberthyer. Kjo ka qenë qendra e parë europiane në Amerikë, të cilën Kolombi e pagëzoi me emrin Navidan<sup>1</sup>).

Kështu u zbuluan ishujt afër Amerikës, të cilët Kolombi i mori për ishuj në brigje të Azisë.

Në fillim të janarit 1493 dy anije muarën rrugën e kthimit për në Spanjë. Mbas stuhirash të tmerrshme, anijet «Pinta» dhe «Nina» u kthyen në Spanjë. Kolombi lajmëroi zbulimin e rrugës së re për Azi. Ai solli në Europë disa «indianë», pak ar, bimë të panjohura dhe penda shpezësh të egra.

Pas lundrimit të tij të parë Kolombi shkoi edhe tri herë — 1493, 1498, dhe 1502 në ishujt e zbuluar prej tij në brigjet e vetë kontinentit. Por

1) Krishtlindje

22857 *[signature]*

derisa vdiq ai qe krejt i bindur se kishte arritur brigjet e Azisë.

Qeveria spanjolle, e cila nga zbulimi i tokave të reja pati përfitime të mëdha materiale, nuk e shpërbleu lundërtarin e guximshëm për zbulimet e tij. Ajo tregoi mosbesim kundrejt Kolombit, mbasi kishte frikë se mos ai do të vinte krejt në sundimin e tij tokat e zbuluara. Prej lundrimit të tretë Kolombin e sollën lidhur në pranga. Ai u detyrua të bëjë përpjekje të mëdha të provonte se ishte i pafajshëm dhe të lejohej të shkonte edhe një herë përtej oqeanit. Pas lundrimit të katërt Kolombi vdiq po aq i varfër, sa ç'kishte qenë para udhëtimit të tij të madh.

Pas Kolombit në tokat e zbuluara vrapuan me mijra kolonizatorë spanjollë, që donin të pasuroheshin pa mundim. Për të gjetur ar dhe gjera të tjera të çmueshme, ata zbuluan ishuj të rinj dhe depërtuan gjithnjë më thellë në kontinent. Ata themeluan qendra banimi spanjolle duke robëruar dhe çfarosur vendasit. Që kur bëri udhëtimin e tij të dytë Kolombi u vuri tatim për frymë më se një milion banorëve të ishullit Spaniola të zbuluar prej tij. Ndjekjet mizore të popullsisë bënë që 20 vjet pas zbulimit të Espanjolës të mbeteshin vetëm 15 mijë vendas dhe pas 30 vjetësh të çfaroseshin krejt.

Po këtë fat pësuan edhe banorët e ishujve të tjerë si dhe një pjesë e madhe e kontinentit. Duke përdorur të gjitha mjetet e dhunës, të tradhëtisë, e mashtrimit, me zjarr dhe shpatë, duke plaçkitur dhe çfarosur vendasit, nëpër tokën e actekëve — Meksikë — kaluan njësitë ushtarake të Kortesit, nëpër tokën e inkëve — Peru — njësitë e Pizarros. Lëkundja që u vu re në fillim në Spanjë në lidhje

me zbulimet e Kolombit u kthye në etje dhe aspiratë, që brenda një kohe sa më të shkurtër të shfrytëzonin thesaret e zbuluara dhe të pasuroheshin me grabitje. Mbasi i shfrytëzuan këto vende, pushtuesit jo vetëm që zhdukën kulturën e lartë të vjetër të popujve që banonin atje por edhe çfarosën pjesën më të madhe të popullsisë. Ata që mbetën u kthyen në skllëvër dhe u detyruan të punonin në miniera ose në plantacionet e pushtojësve spanjollë. Indianët (banorët vendas) gjetën vdekjen në masë nga kjo punë shumë e rëndë. Kjo shkaktoi që kolonizatorët spanjollë filluan gjuetinë e zezakëve në Afrikë. Mijra e mijra skllëvër zezakë u sollën në këtë kohë nga Afrika për të zëvendësuar indianët që po çdukeshin. Filloi edhe për ta tragjedia që po vazhdon dhe në ditët tona: shtypja, shfrytëzimi dhe diskriminacioni racial.

## RRUGA DETARE PËR NË INDI

Lundrimet e Kolombit në perëndim dhe zbulimi i ishujve tej oqeanit Atlantik, që mendohej se ishin portat e hyrjes në Indi, e shqetësuan shumë qeverinë portogezë.

Pas lundrimit të Bartolome Diac, që arriti kepën e Shpresës së Mirë (1488), flotës portogezë i hapeshin perspektiva të mëdha për t'i shkuar rreth e rrotull Afrikës. Qëllimi i saj ishte të hynte në oqeanin Indian dhe të arrinte në Indinë me pasuri përrallore, duke ua kaluar spanjollëve në këtë drejtim. Po nëgoftëse Kolombi kishte arritur me të vërtetë deri në Indi me anijet spanjolle? Atëhere Spanja do të shfrytëzonte pasuritë dhe fitimet e tregëtisë me Indinë, ndërsa Portugalia që kishte bërë

aq përpjekje për të gjetur rrugën detare për në Indi dhe në ishujt e beharnave, do të mbetëj me gisht në gojë. Qeveria portogjeze nuk mund të lejonte një gjë të këtillë.

Në kohën kur Kolombi përgatiste në Spanjë ekspeditën e tij të tretë për perëndim, portogezët nisen me shpejtësi për të gjetur rrugën rreth Afrikës




Fig. 3. Harta e lundrimit të Vasko de Gamës.

për në Indi një skuadër të përbërë prej tri anijesh dhe një anije ndihmëse me ushqime. Në ekspeditë merrnin pjesë 170.

Skuadra u nis nga Lisbona në verën e vitit 1497. Ekspeditën e udhëhiqte një lundërtar i ri, 28 vjeçar, i quajtur Vasko de Gama.

Mbasi kaluan ishujt e Kepit të Blertë, anijet u nisën për në jugperëndim për të mos udhëtuar kundër rrymës në brigjet e Afrikës. Ata vazhduan në lindje dhe iu afruan Afrikës në gjirin e Shën Elenës. Katër muaj e gjysëm pas largimit nga Lisbona, anijet, duke udhëtuar ngadalë në drejtim jugor, arritën në kepën e Shpresës së Mirë dhe iu afruan bregut lindor, duke i dhënë emrin Natal.!)

Në fund të janarit 1498 skuadra hyri në grykën e lumit të fuqishëm Zambezi. Mbasi e çpalli këtë vend pronë të Portugalisë, Vasko de Gama qëndroi këtu një muaj për të riparuar anijet.

Detarët vunë re se zezakët vendas visheshin me robe, që i blenin nga tregëtarët arabë. Duke udhëtuar drejt veriut ata gjatë rrugës u ndeshën me anije arabe. Më vonë panë se në bregun lindor të Afrikës gjendeshin qytetet Mozambik dhe më tutje Mombasa, Malindi.

Tregëtarët dhe sundimtarët e Mozambikut dhe të Mombasit i pritën me armiqësi portogezët, deshën t'u çkatërronin anijet dhe të zinin rob detarët. Këtë punë ata mund ta bënin pa ndonjë vështirësi: portogezët nuk kishin harta dhe nuk dinin rrugët e përshtatëshme për lundrim. Për më tepër ata e përballonin me vështirësi të madhe nxehtësinë ekuatoriale, vuanin nga skorbuti dhe kishin humbur rreth gjysmën e ekipazhit. Vetëm

1) Krishtlindje

me ndihmën e lundëtarëve abisinas, që ndeshën këtu portogezët, mundën të shpëtojnë nga qëllimet e këqia të arabëve, u futën me shpejtësi në det dhe pastaj arritën në portin Malindi. Sundimtari (shahu) i këtij porti, që ishte në armiqësi me shahun e Mombasit, e priti Vasko de Gamën miqësisht, bëri me të aleancë kundër shahut të Mombasit dhe i dha një shoqërues me eksperiencë, që e dinte rrugën për Indi.

Duke përfitur nga era e mbarë (musoni jugperëndimor), pas tri javë lundrimi, anijet portogezë arritën në bregun malor të Indisë, të mbuluar me një bimësi të harlisur tropikale. Shumë fshatra, të shpërndara gjatë bregut, humbisnin në blerim. Pas tri ditë udhëtimit në jugë, më 20 maj 1498 skuadra arriti në qytetin e bukur me popullsi të madhe të Kalikutës. Këtu gjindeshin shumë anije, me qindra lundra dhe nuk dëgjohej vetëm gjuha indiane, por edhe gjuha arabe dhe gjuhët e tjera.

Vasko de Gama vendosi t'i mbushë anijet e tij me beharna të çmueshme. Por takimi i parë i portogezëve në Indi nuk kaloi pa përleshje. Tregëtarët arabë, duke e kuptuar se portogezët do të bëheshin konkurrentë të fortë të tyre, i bindën autoritetet e vendit të arrestonin portogezët si piratë. Kështu ata arrestuan krejt detarët që ishin urdhëruar nga Vasko de Gama të grumbullonin beharna. Por Vasko de Gama mori masa mbrojtëse: ai mbajti në anije parinë e njohur të qytetit që kishin ardhur për të admiruar anijet europiane dhe pajisjet e tyre që nuk i kishin parë kurrë.

Kur mori vesh këtë, sundimtari (raxhai i Kalikutës), liroi portogezët dhe dërgoi anije për të marrë banorët e Kalikutës, që ishin mbajtur në anije. Vasko de Gama futi në anije shokët e tij dhe dha

urdhër të qëllojshin me topa anijet. Duke marrë me vete robët, ai mori rrugën e kthimit.

Në janarin e vitit 1499 anijet arritën në gadi-shullin e Somalisë, në skelën Mogadisho dhe në gusht u kthyen në atdhe. Lundrimi zgjati dy vjet e dy muaj. Më se njëqind detarë vdiqën rrugës nga skorbuti: u kthyen vetëm 55 veta.

Lundrimin e Vasko de Gamës e këndoi poeti i njohur portogez Kamoens në poemën «Luziada».

Me këtë udhëtim filloi pushtimi i Indisë nga europianët dhe shndërrimi i saj në koloni.

Pas udhëtimit të Vasko de Gamës në Indi filluan të nisen çdo vit anije portogezë. Një pjesë të bregdetit të Industanit portogezët e kthyen në koloni të tyre.

Portugalia e mbajti në duart e saj për 90 vjet rrugën për Indi rreth Afrikës. Më vonë deri në hapjen e kanalit të Suezit (1869), tregëtia me vendet e Lindjes, nëpër këtë rrugë, u bë prej shtetesh detare më të forta — prej Francës dhe Anglisë.

Popujt e Indisë ranë nën sundimin e shteteve të Europës Perëndimore dhe provuan zgjedhën e rëndë të kolonizatorëve shekuj me rradhë.

## **NGA KA RRJEDHUR EMRI «AMERIKË»**

Për të kontrolluar rrugën e re detare për Indi, që kishte zbuluar Kolombi, portogezët vendosën të dërgojnë një ekspeditë të tyre. Mjaft lundëtarë në fillim të shek. XVI u larguan nga Flota spanjolle dhe hynë në shërbim të flotës portogezë. Ndër ta ishte edhe lundërtari Amerigo Vespuçi.

Ky ishte bir i një noteri nga qyteti i Firencës (Itali) Në fillim prindët e kishin vënë Amerigon

në shërbim të familjes Medici. Në vitin 1492 kur Kolombi bëri zbulimin e tij, kjo familje e dërgoi Vespuçin si njeri të besuar për çështje financiare në Spanjë. Kur muarën vesh zbulimin e rrugës së re për Indi nga Kolombi dhe parashikuan mundësinë e grumbullimit të kapitaleve të reja, familia Medici vendosi të dërgojë Vespuçin në «Indi».




Fig. 4. Harta e lundrimeve të Amerigo Vespuçit.



Në vitin 1499 Vespuçi u nis për udhëtimin e gjatë të ekspeditës spanjolle nën kryesinë e Ohe-dës, që kishte marrë pjesë në udhëtimin e dytë të Kolombit.

Anijet çanë oqeanin dhe arritën në kontinen-tin e ri pak më në veri të grykës së Amazonit. Prej këndej u kthyen gjatë bregut të kontinentit në detin e Karaibeve. Rruga bregdetare shumë e gjatë, i bindi lundëtarët se ata ishin duke udhë-tuar gjatë bregut të një vendi të madh.

Mbasi u kthye nga lundrimi i tij i parë nga Bota e re, Vespuçi e braktisi familjen Mediči dhe hyri në shërbim të portogezëve. Më 1501 ai u nis për-sëri në perëndim me një anije portogeze si astro-nom. Kësaj radhe anijet e ekspeditës iu afruan to-kës 5<sup>o</sup> në jugë të Ekuatorit, tek kepi më lindor i kontinentit. Lundëtarët i dhanë këtij em-ri «Kepi i Rokut», emër që e mban edhe sot.

Pastaj anijet udhëtuan gjatë bregut në jug dhe pas pak kohe u gjenden tek gryka e një lumi, të cilin e pagëzuan me emrin «Rio de Zhaneiro, që do të thotë «Lum i janarit» (kjo ndodhi më janar). Mbasi arritën 22<sup>o</sup> gjerësi jugore anijet u drejtuan nga oqeani i hapur, zbritën më në jug dhe pastaj u drejtuan nga Afrika dhe më në fund arritën në kryeqytetin e Portugalisë — Lisbonë. Pjesë-marrësit e ekspeditës u bindën se toka që ki-shin zbuluar ata nuk ishte Azia, sepse dihej që-kur se tërë kontinenti i Azisë gjendej në hemiste-rin verior. Kurse toka e re shtrihej thellë në jug, pas tropikut të jugut.

Në vitin 1503 Amerigo Vespuçi i shkroi një letër zotnisë së tij të dikurshëm Mediči në Itali, ku vinte në dukje se vendet, që kishte parë ai duhen quajtur «Botë e re». Po në atë vit Vespuçi u nis

përsëri për të gjetur rrugën për Azi, drejt ishujve Molukë, të njohur për beharnat e tyre.

Ekspedita e bindi akoma më shumë se «Bota e re» nuk ishte Azia. Në vitin 1504 ai i shkroi për këtë një miku të tij në Itali.

Mbasi u kthye nga ekspedita, Vespuçi hyri në shërbim të Spanjës. Atij iu desh të lundrojë drejt ishujve që kishte zbuluar Kolombi.

Katër vjetët e fundit të jetës së tij (1508–1512) Amerigo Vespuçi shërbeu në Spanjë dhe u muar me ndërtimin dhe hartimin e globeve dhe të hartave në bazë të materialeve të ekspeditave. Punë të madhe bëri në lidhje me hartimin e hartës së përgjithëshme sekrete të tokave të zbuluara.

Dy letra të Vespuçit, mbi lundrimet e tij, u përkthyen në gjuhën latine dhe frënge. Në vitin 1507 në Francë u botua një libër i vogël me titullin «Hyrje në kosmografi» dhe në të u vunë të dyja këto letra. Në këtë libër ndeshet për herë të parë emri «Amerikë». Autori i librit — anëtar i rrethit gjeografik të qytetit Sën-Die-Valdzemyler shkruante se deri tani njiheshin tri pjesë të botës — Europa, Azia dhe Afrika, por tani «këto kontinente të botës janë studiuar gjerësisht dhe është zbuluar pjesa e katërtë e botës prej Amerigo Vespuçit... Unë nuk e marr me mend përse, kush dhe me çfarë të drejte mund të na ndalonte ta quanin këtë kontinent Amerigo ose Amerikë sipas emrit të zbuluesit të saj Amerigo, që është burrë me mendje të ndritur».

Pas një kohe të shkurtë në vendet e ndryshme, ku u botua libri i Veldzemylerit, dolën disa harta, në të cilat «Bota e re» quhet «Amerikë». Në shumicën e hartave kjo pjesë e botës është ndarë prej një ngushtice nga tokat e zbuluara nga

Kolombi. Kështuqë në fillim emri «Amerikë» i përkiste vetëm Amerikës Jugore.

Në vitin 1538 doli harta e botës dhe në vitin 1541 doli në dritë globi i kartografit të njohur holandez Merkator. Në të ishin paraqitur të dyja pjesët e reja të botës me emrin e përbashkët «Amerikë».

Që nga gjysma e dytë e shek. XVI ky emër mbeti në harta për tërë kontinentin.

Emri i lundërtarit dhe zbuluesit italian u shënuar në hartën gjegjësisht në hartën gjeografike, megjithëse disa shkencëtarë edhe atëhere bile dhe më vonë protestuan kundër kësaj.

## LUNDRIMI I PARË RRETH BOTËS

Për kohën e tij Kolombi ka qenë ndër të pakët që mendonte se Toka është e rumbullakët. Këtë e bindën sidomos disa vepra të shkencëtarëve grekë. Nga një libër i vjetër Kolombi mësoi se perimetri i Tokës është 180 mijë stade<sup>1</sup>) (rreth 33 mijë km). Kur Kolombi hartoi projektin e lundrimit të tij për në Azi, ai nuk dyshonte për trajtën sferike të Tokës dhe ishte i bindur se do të arrinte deri në Indi, në rast se do të ndiqte drejtimin nga perëndimi. Por kur përshkoi oqeanin Atlantik, sipas llogarive të tij dilte se ai kishte bërë gati gjysmën e perimetrit të Tokës.

Gjatë lundrimit të Amerigo Vespuçit në Amerikën Jugore u pa se bregu i «Botës së re» që kishte zbuluar ai, priret dalëngadalë nga jugperëndimi. Kjo dha shkas të mendohet se nga jugu kon-

1. Stadi kishte një gjatësi prej 158-185 m.

inenti ngushtohet në formë të një pyke, duke formuar një gadishull. Kalimi i Vasko Balboas nëpër istmin e Panamasë dhe zbulimi i «Detit Jugor» prej tij i shtyu udhëtarët të mendonin se kontinenti i Amerikës Jugore laget edhe nga perëndimi po prej këtij deti. Lundëtarët mendonin se po t'i shkolin për rreth «Botës së re» nga jugu, atëhere do të dilnin në «Detin Jugor» dhe pastaj të arrinin në Indinë e vërtetë.

Orvatje për t'i shkuar Amerikës për rreth nga jugu u bënë shumë herë. Kështu, në vitin 1515 spanjulli Solis lundroi deri tek gryka e lumit La Plata, ku u vra prej indianëve. Pas katër vjetësh bëri orvatje për t'i kaluar për rreth Amerikës Jugore Ferdinand Magelani. F. Magellani me origjinë portogezë, që më 1506–1511 mori pjesë në ekspeditën rreth Afrikës dhe në pushtimin e bregut të Industanit prej portogezëve. Mbase portogezët nuk e graduan, ky vendosi të vihej në shërbim të Spanjës. Duke besuar, ashtu si dhe Kolombi, se Toka është e rrumbullakët, Magelani i paraqiti mbretit të Spanjës projektin e tij për të gjetur rrugën perëndimore për Azi.

Për lundrimin e Magelanit u përgatitën pesë anije të vogëla: «Trinidad», «San Antonio», «Santiago», «Konsepsion» dhe «Viktoria». I tërë ekipazhi përbëhej prej 265 veta.

Më 20 shtator 1519 anijet u larguan nga gruka e Guadalkuivirit

Në nëndor skuadra arriti në Amerikën Jugore dhe u drejtua gjatë bregut të detit në jugë. Në prillin e vitit 1520 anijet dimëruan në limanin San Hulan në 49° gjerësi jugore.

Kapitenët e tri anijeve «Viktoria», «Konsepsion», «San Antonio» duke patur frikë të kalonin

dimrin në një vend të panjohur ngritën krye kundër Magelanit, i cili, ky i fundit, menjëherë i shtypi kryengritësit. Për kapitenët e anijeve «Viktoria» dhe «Konsepsion» urdhëroi dënimin me pushkatim, ndërsa kapitenin e «San Antonios» dhe priftin kryengritës i zbriti në një breg të shkretë, shkëmbor, pa jetë, ku me siguri do të gjenin vdekjen.




Fig. 5. Rruga e ekspeditës së Magelanit.

Pas pak kohe i ndodhi një fatkeqësi tjetër anija «Santiago», që ishte dërguar për zbulim, u shkatërrua nga një goditje kundër një shkëmbi. Ekipazhi i saj u vendos në katër anijet e mbetura. Në pranverë anijet u nisën dhe në tetor hynë në një ngushticë të panjohur, që më vonë mori

emrin e Magelanit. Për më tepër një muaj skuadra u end nëpër këtë ngushticë dhe në degëzimet e saj të shumta. Kur anijet kaluan rreth skajit jugor të Amerikës, natën detarët panë në jug drita zjarrësh në ishuj. Magelani i dha emrin këtij arqipe-lagu «Toka e Zjarrtë». Në këtë kohë kapiteni i ri i anijes «San Antonio» duke mos i bërë dot ballë vështirësive dezertoj dhe u kthye në Spanjë. Atje ai çpifi kundër Magelanit, duke e akuzuar për tradhëti ndaj qeverisë.

Më 28 nëndor 1520 tri anije të Magelanit, mbasi kaluan Amerikën nga jugu, hynë në një oqean të panjohur, një pjesë të të cilit e kishte quajtur më parë Balboa «Deti Jugor». Anijet e Magelanit lundruan në oqean gjithnjë në drejtim të perëndimit për gati katër muaj. Lundrimi që shumë i vështirë. Rezervat e ushqimeve po mbaronin.

«Peksimadhet, me të cilat ushqeheshim, — ka shkruar në ditar një pjesëmarrës i ekspeditës — Antonio Pigafeta, ishin bërë pluhur i përzier me krimba dhe me të ndyra mijsh dhe prandaj kishin një erë të keqe të padurueshme. Ne pinim ujë të prishur, që kishte gjithashtu erë të padurueshme. Ne kemi ngrënë lëkurat e drurëve të dyrekëve. Këto lëkura ishin forcuar aq shumë, sa që vuhej t'i linin të zbuteshin katër—pesë ditë në ujë të kripur. Këto pastaj i pignim dhe i hanim. Shpesh herë hanim tallash dhe bile minjtë, aq të neveritur për njeriun, ishin bërë gjellë aq e shijshme, sa që për ta paguanim gjysmë dukati për një kokë».

Thua se i tërë ekipazhi u sëmur nga skorbuti. Shumë vdiqën. Gjatë gjithë kohës së lundrimit prej anijeve u panë vetëm dy ishuj të pabanuar.

Më në fund, në marsin e vitit 1521 u dukën tre ishuj (prej grupit të ishujve Mariane), të cilët

Magelani i pagëzoi me emrin ishuj të Hajdutëve, nga shkakut se banorët e tyre, duke ardhur me lundrat e tyre në anije, u vodhën lundëtarëve shumë plaçka dhe bile një lundër.

Ekspedita vazhdoi udhëtimin më tutje dhe pas pak kohe arriti në ishujt Filipine. Mbasi e frikësoi sundimtarin e ishullit Sebu me forcën e armëve të tij, Magelani e detyroi t'i nënshtrohej Spanjës. Këtu Magelani u përzie në luftën midis banorëve të ishujve dhe u vra në ishullin Maktan.

Pas vrasjes së tij komandant i ekspeditës u zgjodh Barboza. Para largimit të anijeve sundimtari i ishullit Sebu ftoi një pjesë të ekipazhit në një gosti lamtumire, sulmoi tradhëtisht të ftuarit dhe vrau 27 veta; midis të vrarëve që edhe Barboza dhe astronomi i ekspeditës San Martin.

Në përbërjen e ekspeditës mbetën më pak se 120 veta. Ata nuk mjaftonin për të mbajtur tri anije, prandaj vendosën ta digjinin njerën anije. Për këtë u zgjodh anija «Konsepsion».

Kryetar i ri i ekspeditës u zgjodh Karvalio, por pas pak kohe, ai u rrëzua dhe komandant u bë Espinosa.

Për katër muaj anijet u endën midis ishujve të arqipelagut të Malezisë, duke kërkuar ishujt përrallorë të beharnave. Më në fund lundëtarët arritën tek ishulli Tidor në grupin e ishujve Molukë. Mbasi blenë një sasi të madhe rrënjë karafilash, arrash indi dhe beharnash të tjera, ekipazhi vendosi që anija «Trinidad» të kthehej në Spanjë nëpër Oqeanin Paqësor, ndërsa «Viktoria» të vazhonte rrugën më tutje në perëndim nëpër oqeanin Indian, duke kaluar rreth e rrotull Afrikës.

Me sa duket, ky vendim i lundëtarëve u shkaktua nga frika se mund të binin robë të por-

togezëve, që kishin pushtuar brigjet e Indisë dhe një pjesë të ishujve.

Mbasi anija «Trinidad» nuk u ndihmua nga erërat lindore që ta shpinin në drejtim të Amerikës, ajo u end për gjashtë muaj nëpër oqeanin Paqësor dhe u detyrua të kthehet në ishujt Molukë, ku portogezët zunë rob tërë ekipazhin. Thuajse të gjithë pjesëtarët e ekuipazhit vdiqën si robër të portogezëve në Indi.

Nga e tërë ekspedita e Magelanit arriti me humbje të mëdha vetëm anija «Viktoria».

Kapidani i anijes, spanjoli El-Kano e çoi anijen larg brigjeve, në pjesën jugore të oqeanit Indian me qëllim që të mos ndeshej me flotën portogezë. Anija kishte 47 anëtarë të ekipazhit dhe 13 malajas, që ishin kapur në ishujt e ndryshëm të Indonezisë. Në majin e vitit 1522, kur «Viktoria» iu afrua kepit të Shpresës së Mirë dhe e kaloi atë, kishin mbetur gjallë vetëm 30 spanjollë.

Kur mbaruan rezervat e ujit të pijshëm, El-Kano u detyrua t'u afrohej ishujve të Kepit të Blertë, ku portogezët zunë rob edhe 13 anëtarë të ekipazhit të anijes «Viktoria».

Më 6 shtator 1522 «Viktoria» u kthye në Europë dhe hyri në grykën e Guadalkivirit, duke patur me vete vetëm 17 spanjollë, që kishin mbetur nga ekipazhi i përbërë prej 265 vetësh.<sup>1)</sup>

Kështu mori fund lundrimi i parë rreth botës, i pashëmbëllt për atë kohë, i cili zgjati tri vjet. Tërë udhëtimin e përshkroi me hollësira pjesëtari i

1. Më vonë erdhën në Spanjë robët e ishujve të Kepit të Blertë — 12 spanjollë dhe 1 malajas, lirimin e të cilëve e kishte kërkuar me këmbëngulje Spanja; më 1527 u kthyen nga India edhe 4 spanjollë të mbetur gjallë.



ekspeditës Antonio Pigafeta, që kishte mbajtur di-tarin.

Ky udhëtim pati rëndësi shumë të madhe për shkencën. U provua se kontinenti «Bota e re» (Amerika Jugore) në jugë me të vërtetë ka formën e një pyke. Ngushtica e zbuluar, që ndan Amerikën Jugore prej ishullit të madh Toka e Zjarrtë, mori emrin ngushtica e Magelanit.

Duke kaluar për herë të parë rreth e rrotull Tokës, ekspedita provoi se Toka ka me të vërtetë trajtën e një rruzulli.

## ZBULIMI I AUSTRALISË

Kur Magelani lundronte për në jugë të Amerikës jugore, gjatë udhëtimit rreth botës, pa Tokën e Zjarrtë. Lundëtarët, kur panë bregun e ishullit të madh, menduan se është gadishulli i zgjatur i kontinentit të madh në Polin jugor sipas hartës së Ptolomeut. Zbulimi i ishujve që gjenden në jug të Azisë: Sumatrës, Borneos (Kalimantanit) Celebesit (Sulavesit) nga portogezët dhe sidomos i skajit verior të Guinesë së Re, i shtyu njerëzit të mendojnë se edhe këta ishuj mund të jenë pjesë të kontinentit të panjohur të jugut. Dalëngadalë u formua bindja se në jugun ekstrem të rruzullit të dheut ekziston një kontinent. Ky u quajt Australi (ose më mirë «Terra Australis incognita» — «Toka e panjohur jugore»). Në hartën e kartografit të njohur holandez Orтели (1570) kontinenti jugor është paraqitur si një pjesë shumë e madhe e botës. Kontinenti i panjohur tërhoqi në mënyrë të posaçme lundëtarët e Spanjës. Pas pushtimit të Perusë kolonizatorët spanjollë u nisën shpesh herë prej

këtij vendi në drejtim perëndimor sipas rrugës që kishte bërë Magelani për të shkuar në Ishujt Filipine.

Bindja se ekziston një kontinent jugor u forcua akoma më shumë kur lundërtari spanjoll Mendanja zbuloi në vitin 1568 arqipelagun e ishujve të Solomonit. Një ishull me male të larta dhe të mbuluar me bimësi tropikale Mendanja e kujtoi si kontinent jugor.

Ekspeditën e dytë Mendanja e bëri vetëm pas 27 vjetëve. Gjatë kësaj kohe asnjëri prej europianëve nuk kishte shkuar në ishujt e Solomonit. Mendanja që zbuloi gjatë lundrimit të tij të dytë ishujt Santa-Krus, nuk arriti të gjejë kontinentin jugor.

Më 1605 prej Perusë u nis me tri anije një ekspeditë e re për të gjetur Australinë. Këtë ekspeditë e udhëhiqte Kirosi. Mbasi kaloi midis «grumbullit të ishujve», të arqipelagut Tuamotu (Të ulta), Kirosi arriti deri në grupin e ishujve Santa-Krus. Prej këndej u kthye nga jugu dhe «pa tokën e madhe» malore me pyje të dendura, përrenj të rrëmbyeshëm dhe me fshatra të banuara prej njerëzish me lëkurë të zezë.

Kirosi e quajti këtë vend Australi. Ai ishte i bindur se kishte zbuluar një kontinent të madh. I trullosur nga gëzimi, Kirosi braktisi dy anije dhe u kthye fshehtas me anijen e tij në Peru. Ai vendosi t'i njoftojë i pari autoritetet spanjolle për zbulimin e Australisë dhe të fitojë të drejtën për ta qeverisur atë. Kurse në të vërtetë vendi i zbuluar prej Kirosit ishte arqipelagu i ishujve që sot quhen Hibride të Reja.

Ndërkaq portogezit Torres, kapidan i njerës prej anieeve të braktisura nga Kirosi, studioi ishujt dhe i çoi anijet në perëndim.

Në vitin 1606 ai arriti në bregun jugor të Guinesë së Re dhe zbuloi ngushticën që ndan këtë ishull prej tokës së panjohur, që shtrihet në jugë. Kjo ishte Australia e vërtetë. Kepi që pa Torresi, tani quhet Jork, ndërsa ngushtica midis Guinesë së Re dhe kepit të Jorkut u quajt në shekullin XVIII ngushticë e Torresit.

Kur i njoftoi Torresi autoritetet spanjolle në ishujt Filipine për zbulimin e tij, u vendos që kjo të mbahej fshehtë dhe për më shumë se 150 vjet askush nuk diji për këtë zbulim. Vetëm pas puschimit të qytetit Manila anglezët gjetën në arkiva njoftimin e Torresit. Këtë e botuan vetëm mbasi Xhems Kuku kaloi për herë të dytë në shek. XVIII nëpër ngushticën midis Guinesë së Re dhe Australisë.

Kështu pra, lundëtarët spanjollë arritën në Australi nga lindja. Por kjo nuk do të thotë se brigjet e Australisë nuk i kishte parë njeri nga perëndimi. Në hartat e fshehta portogezë të shek. XVI ishte paraqitur bregu i ishullit të madh të panjohur «Java e Madhe», i cili nga pozicioni gjeografik i përgjigjet bregut të Australisë në perëndim të gjirit Karpentaria. Ndoshta portogezët nuk kishin arritur vetë në këtë breg, por kishin dëgjuar për të prej banorëve vendas dhe në bazë të fjalëve të tyre e kishin paraqitur në hartë.

Thuajse në të njejtën kohë me Torresin, në vitin 1606 lundërtari holandez Janc pa bregun verior të Australisë, duke hyrë në gjirin Karpentaria.

Në fillim të shek. XVII brigjet veriore të Kontinentit jugor njiheshin mirë. Po si ishte ky kontinent më tutje në jug? A shtrihej deri në Polin jugor, siç ishte paraqitur në hartën e Ortelit?

**Përgjigja e këtyre pyetjeve u formua gradualisht, krahas me studimin e kontinentit.**

Në vitin 1616 holandezi Dirk Hartogszon arriti në ishullin e pagëzuar me emrin e tij, që gjendet në anën perëndimore të Australisë në 26° gjërësie jugore.

Por zbulimet më të rëndësishme i bëri holandezi Abel Tasman. Në vitin 1642 ai u nis nga Batavia për të hetuar: a shtrihet Australia deri në Polin jugor? Mbase kaloi ishujt Maurici në oqeanin Indian, mori drejtimin nga lindja dhe, për çudi, hyri në oqeanin Paqësor. Gjatë rrugës ai pa vetëm bregun jugor të njëfarë vendi, të cilin e quajti Vandimen. Më vonë u konstatuan se ky ishte një ishull i madh, që u pagëzua me emrin Tasmani.

Tasmani i kaloi Australisë rreth e rrotull nga jugu dhe nga lindja dhe konstatoi se kishte të bënte me kontinent në vete, që nuk bashkohej në jugë me tokën e Polin jugor. Mbase zbuloi gjatë rrugës Zelandën e Re, Tasmani kujtoi se kjo ishte skaj i kontinentit jugor antarktik. Në këtë mënyrë kufiri i Kontinentit të panjohur jugor u shty larg në jugë.

Por edhe ky supozim i Tasmanit doli i gabuar dhe kjo çështje u sqarua në shek. XVIII nga Xhems Kuku.

Pas lundrimit të Tasmanit lundërtarët, sidomos ata anglezë, përcaktuan gjithnjë më mirë konturat e pjesëve të ndryshme të Australisë. Pjesa lindore e Australisë dhe ishulli Tasmania, u bashkuan me zotërimet e Anglisë pas lundrimit të parë të Xhems Kukut (1768–1771) Konturat e pjesëve jugore të kontinentit u përcaktuan vetëm në fund të shek. XVIII, kur në portin e Xheksonit (Sidneit)

u vendosën anglezët dhe filluan të bëjnë rilevimin e brigjeve në harta më të sakta.

Në vitin 1798 Bassi lundroi me një barkë të thjeshtë për njëmbëdhjetë javë gjatë gjithë bregut jugor të Australisë dhe e përshkroi krejt atë. Pastaj me anijen Norfolk ai kaloi nëpër ngushticën në mes të Australisë dhe Tasmanisë, duke i ardhur rreth e rrotull tokës së vogël të Tasmanisë, kështu provoi karakterin ishullor të saj.

Ngushtica midis kontinentit dhe ishullit u quajt me emrin e tij ngushtica e Bassit.

Gjatë shek. XIX një sërë ekspeditash—ekspedita e M. Flidersit, T. Mitçelit, D. Stiuardit, D. Mak—Kinlit, P. Uorbertonit, A. Forrestit etj. stiduan pjesët e brendëshme të Australisë. Gjatë kësaj periudhe u themeluan edhe qytetet kryesore të vendosura në bregun e kontinentit.

Australia Jugore u bashkua me Anglinë në vitin 1829. Në fillim Australia u popullua edhe nga keqëbërës të dërguar në këtë kontinent nga Anglia. Kolonizatorët e parë europianë u sollën mizorisht me vendasit — australianët. Pjesa më e madhe e vendasve u çfaros, ndërsa të tjerët u shtynë në krahinat shterpër, shkretëtirë të Australisë, ku australianët jetojnë edhe sot në kushte shumë të vështira. Sot kanë mbetur rreth 60 mijë vetë.

## LUNDRIMET E XHEMS KUKUT

Në gjysmën e dytë të shek. XVIII kapitalizmi që po zhvillohej me shpejtësi në vendet e përparuara të Europës, kërkonte zgjerimin e zbulimeve koloniale. Kapitalistëve u nevojiteshin kolonitë e

reja për të sjellur prej andej lëndët e para për industrinë që po rritej me shpejtësi dhe për të çuar në koloni mallra industriale. Zakonisht pushtimit të kolonive të reja u prinin ekspeditat shkencore, që shënonin në hartë tokat e zbuluara rishitas dhe studionin pasuritë e tyre.

Në këtë kohë vend industrial më i zhvilluar ishte Anglia. Për këtë arsye kapitalistët anglezë dëshironin të zgjeronin pronat e tyre koloniale. Anglia kishte flotën detare më të madhe.

Lundrimi më i rëndësishëm rreth botës nga pikëpamja shkencore, që kishte për qëllim zbulimin e tokave të reja dhe studimin e oqeaneve, ka qenë ekspedita angleze e Xhems Kukut.

Kuku ish bir i një argati. Së bashku me babanë, me motrat dhe vllazërit e shumtë (ai ishte femija i nëntë në këtë familje) filloi të punojë që në moshën 7 vjeçare në pronën e një çifligari të madh. Kuku, duke qënë kështu i varfër, filloi të mësoi në shkollën e fshatit të tij vetëm kur mbushi 13 vjetët. Pas pak kohe Xhemi megjithse mjaft i ri hyri si muço në një anije që bënte udhëtime të shkurta (bregdetare). Që nga kjo kohë jeta e Kukut u lidh me detin.

Duke lundruar me anije të vogëla, në fillim si muço dhe pastaj si detar, Xhemi u tregua detar i zellshëm dhe i mprehtë dhe në moshën njëzetvjeç bëhet kapiten anije.

Në fillim të luftës shtatëvjeçare midis Francës dhe Anglisë Kuku u regjistrua si vullnetar në flotën ushtarake angleze dhe u caktua me shërbim në anijen «Shqiponja» me gjashtëdhjetë topa. Pas pak kohe kapitenit i tërhoqi vemendjen vullnetari kureshtar dhe filloi t'i japë Kukut libra mbi lundrimin, astronominë dhe matematikën, duke u për-

pjekur me të gjitha mënyrat ta gradonte detarin, talentuar.

Ne vitin 1759 kuku fitoi gradën e parë si oficer dhe u nis në Kanada. Këtu në një betejë me francezët në lumin Shen-Lorenc kreu një detyrë me pergjegjesi; tarrë ater vendosjes së ushtrisë frënge ai mati lumin dhe përpiloi një hartë të saktë të vijës së lundrimit. Kjo punë duhej bërë naten. Një herë armiku e zbuloi guximtarin. U dëturua të kapte lopatat dhe të largohej sa më parë nën mbrojtjen e rojes angleze. Posa zbriti Kuku në breg dhe u fsheh pas një shkëmbi, armiqët shtinë në dorë varken e tij.

Fama e mjeshterisë, me të cilën ishte përpiluar harta e lumit, që siguronte kalim të lire dhe manovrim të anijeve, u përhap neper tërë skuadren. Komandanti kerkoi transferimin e Kukut në anijen e komandantit. Këtu Kukut iu dha mundësi akoma me e madhe për të treguar talentin e tij. Brenda një kohe të shkurtë, Kuku fiton autoritet në komandën e lartë në sajë të punës së tij të përpiktë dhe të shpejtë. Atij i besojnë rëlevimin topografik të brigjeve dhe përshkrimin e njerës nga skelat e ishullit Njufauldland, ku anglezët kishin ndermend të krijonin një bazë ushtarake-detarë. Kryerja me sukses e kësaj pune e nxiti komandën t'i besojë togerit Kuk rëlevimin kartografik të krejt Njufauldlenit dhe të bregut lindor të gadishullit Labrador. Gjatë kësaj pune, që vazhdoi për disa vjet, Kuku zbuloi dhe shënoi në harta të sakta disa liqene.

Ne vitin 1768 admiraliati britanik vendosi të dërgojë një ekspeditë të oqeanit Paqësor në hemisferën jugore. Nxitje për këtë që raporti i Shoqërisë shkencore mbretërore të Londrës (Akademisë

së shkencave të Anglisë) mbi rëndësinë e vrojtimit astronomik në lidhje me kalimin e planetit Venus nëpër diskun e Diellit, që do të ndodhte më 1769. Ky fenomen mund të vërehej më mirë në njërin nga ishujt e pjesës jugore të oqeanit Paqësor. Për këtë qëllim u zgjodh ishulli Taiti, që posa ishte zbuluar.

Shoqëria shkencore mbretërore rekomandoi të vihej në krye të ekspeditës një shkencëtar. Por admiraliati i vuri ekspeditës detyra shumë më të gjera se sa vrojtimet astronomike. Ai shpresonte të zbuloheshin toka të reja për t'ia aneksuar perandorisë britanike dhe prandaj kryetar i ekspeditës duhej të ishte një detar i vendosur dhe me eksperiencë i flotës luftarake. Brenda një kohe të shkurtë u çfaq mendimi unanimitet se kandidaturë më e mirë për postin e komandantit të anijes nuk mund të pritej se ajo e Xhems Kukut.

Në vitin 1768 me anijen «Ëndëvor» («Orvartja») Kuku u nis për udhëtimin e tij të parë rreth botës. Anija përshkoi oqeanin Atlantik dhe, mbasi i kaloi për rreth kepit Horn, hyri në oqeanin Paqësor. Mbas një lundrimi të gjatë iu afrua bregut të ishullit Taiti, që ishte i mbuluar me një bimësi të begatëshme tropikale.

Pas vrojtimit në lidhje me errësimin e planetit Venus anëtarët e ekspeditës studiuan për një muaj të tërë natyrën e ishullit, jetën dhe mënyrën e jetesës së popullsisë. Ata kaluan me varkë rreth ishullit.

Mbasi u largua prej Taitit, «Ëndëvori» mori drejtimin nga jugperëndimi. Pas 40 ditë lundrimi detarët panë përsëri tokë. Vagmale të larta, të mbuluara me dëborë shtriheshin gjatë bregut. Kuku mendoi se ky ishte pikërisht ai kontinenti mi-






Fig. 6. Harta e udhëtimeve të Xhem s Kukut.

sterioz i jugut, të cilin e kishin kërkuar për një kohë aq të gjatë dhe pa dobi lundëtarët në shek. XVII. Ai nuk e dinte se këtu kishte qenë në vitin 1642 lundërtari holandez Tasman, që e konsideroi gjithashtu këtë tokë si pjesë të kontinentit jugor.

«Endëvori» hodhi ankorën në njerën prej skelave të përshtatëshme. Pas pak kohe u dukën banorët vendas, të armatosur me heshta dhe me sopata guri. Ata nuk i lanë anglezët të zbrisnin në breg. Gjatë përlëshjes u vra një vendas.

Kuku notoi për më se tre muaj gjatë brigjeve të kësaj toke të panjohur. Ai shënoi me kujdes në hartë vijën e bregut që kishte një gjatësi më se 3800 km. Vërtetoi se toka, të cilën si Kuku, ashtu edhe dikur Tasmani e kishin konsideruar si kontinent të jugut, përbëhej prej dy ishujsh, të ndarë nga një ngushticë. Kjo ishte Zelanda e Re.

Ngushtica midis ishujve mban sot emrin e Kukut.

Xhems Kuku studioi i pari natyrën dhe mblodhi të dhëna mbi doket dhe zakonet e banorëve të Zelandës së Re. Ai vuri re se ishulli jugor ishte thujse i pabanuar, ndërsa ishulli verior, ku klima ishte më e butë, kishte popullsi mjaft të dendur, tokat ishin të punuara, nëpër pyjet e dendura gjendeshin shumë zogj këngëtarë, jetonin minj dhe qen, që banorët i hanin. Banorët e Zelandës së Re ishin të gjatë dhe të zhvilluar mirë fizikisht. Shumë prej tyre kishin në trup tatuazhe me lajle fantastike. Vendasit dinin të ndërtonin anije të mëdha detare, që merrnin 40–50 vetë.

Mbasi u largua prej brigjeve të Zelandës së Re, Kuku i drejtoi anijet nga perëndimi. Pas pak kohe pa brigjet e një toke të madhe. Siç u provua

më vonë ky ishte bregu lindor i Australisë. Bregun perëndimor e kishte zbuluar që më 1606 lundërtari holandez Janc. Deri në këtë kohë këtij kontinenti nuk i ishte afruar askush nga lindja. Kuku studioi i pari bregun lindor të Australisë.

Lundrimi rreth brigjeve të Australisë ishte duke marrë fund, kur befas natën ndodhi një fatkeqësi: anija u ngul në cektësirë. Në barkun e anijes filloi të hyjë ujë. Kështu u detyruan të hedhin nga anija gjashtë topa, vozat e tepërta me ujë, pajime dhe shumë ngarkesa të tjera. Sado që u përpoqën ta nxirrnin anijen nga cektësira, ajo qëndronte e ngulur në shkëmbin koralian. Më në fund, në çastin e baticës më të madhe me përpjekjet e gjithë ekipazhit anija mundi të çkulet nga shkëmbi dhe të çohet në grykën e një lumi të vogël për t'ia mbyllur vrimën.

Kuku e kaloi me kujdes të madh anijen midis shkëmbejve, dallgëve si dhe shkëmbejve nënujorë. Më në fund arriti skajin më verior të Australisë — kepin Jork dhe hyri në ngushticën e Torresit, që ndan Guinenë e Re prej Australisë.

Duke u kthyer Kuku hyri në ishullin Java dhe, mbasi kaloi nëpër oqeanin Indian, në vitin 1771 u kthye në Angli. Lundrimi i tij zgjati dy vejt e nëntë muaj e gjysmë.

Gjatë ekspeditës së parë rreth botës Kuku nuk arriti të zbulojë në jugë të Australisë kontinentin e madh jugor.

Për të zbuluar përfundimisht, a ekziston apo jo ky kontinent qeveria angleze përgatiti një ekspeditë të re nën komandën e kapitenit Kuk, të përbërë prej dy anijesh — «Rezulushen» («Vendimi») dhe «Advënçer» («Aventura»).

Anijet u nisën nga Anglia në vitin 1772. Mba-

si arritën kepën e Shpresës në Mirë, ato u drejtuan nga jugu. Pas pak kohe filloi të ftohtit, filluan të shihen akullnaja notuese, u duk megjulla. Mbas ndeshi në një fushë kompakte akulli, Kuku u detyrua të kthehej në lindje. Anijet kalonin gjatë buzës së akullnajave midis maleve notues të akullit. Rreziku u bë akoma më i madh gjatë një stuhie, kur blloqet e akullit ndesheshin me zhurmë të madhe midis tyre, duke kërcënuar çdo çast të shtypnin anijet.

Pas shumë përpjekjesh për të depërtuar në jugë, Kuku u kthye nga veriu. Atij iu mbush mendja top se në polin e jugut nuk ekziston ndonjë tokë e madhe.

Duke lundruar nëpër oqeanin Paqësor, Kuku u kthye përsëri në ishullin Taiti, që bën pjesë në arqipelagun e Shoqërisë, zbuloi shumë ishuj të rinj, duke përfshirë edhe Kaledoninë e Re.

Lundrimi i dytë i Kukut zgjati 3 vjet e 18 ditë.

Pas ca kohe Kuku pranoi propozimin të udhëhiqte një ekspeditë, e cila duhej të kalonte prej oqeanit Paqësor në oqeanin Atlantik gjatë brigjeve të Amerikës Veriore. Në vitin 1776 me anijen «Rezolushën» dhe anijen e re «Diskoveri» («Zbulimi») ai u nis për udhëtimin e tretë dhe të fundit.

Anijet lundruan për një kohë të gjatë në pjesën tropikale të oqeanit Paqësor. Atje u zbuluan disa ishuj të rinj. Pastaj Kuku u drejtua nga veriu. Pas pak kohe panë nga anijet një tokë të re: Ishin ishujt Hapaj deri atëherë të panjohur.

Banorët e këtyre ishujve i pritën anglezët miqësisht: ata u sollën shumë fruta, rrënja të ngrënëshme, derra, i ndihmuan detarët të mbushnin vozet me ujë të pijshëm dhe t'i ngarkonin në lu-

ndra. Shkencëtarët që bënë pjesë në ekspeditë u futën në thellësitë e ishujve për të bërë studime.

Prej ishujve Havaj anijet morën drejtimin nga lindja, drejt brigjeve të Amerikës dhe pastaj vazhduan rrugën e gjatë të tyre në veri.

Duke u futur nëpër ngushticën e Beringut në oqeanin e Ngrirë të Veriut, ata ndeshën në akullnaje të mëdha notuese. Kuku vendosi të kthehej për dimërim në ishujt Havaj.

Por kësaj radhe anglezët nuk mundën të rregulloheshin me vendasit dhe i bënë ata kundërshtarë. Në një përleshje të ashpër kapiteni u vra.

Udhëtimet e Xhems Kukut sollën shumë gjera të reja për zhvillimin e shkencës gjeografike. Ai depërtoi më tepër se paraardhësit e tij në gjerësitë jugore. Në ekspeditat e tij muarën pjesë shkencëtarë-natyralistë, që mblodhën material të ndryshëm shkencor mbi natyrën dhe popullsinë e ishujve të shumtë të zbuluar prej tij. Lundrimet e tij janë të çmueshme për zhvillimin e shkencës gjeografike për faktin se ato dhanë me saktësi njohuritë mbi pjesët jugore të oqeanit Atlantik, Indian dhe Paqësor.

## UDHËTARI DHE GJEORAFI

### ALEKSANDËR HUMBOLDT

Në mbarim të shek. XVIII në hartën gjeografike të lëmshit të dheut ishin shënuar me saktësi mjaft të madhe konturat e të gjitha kontinenteve. Si vende të panjohura kishin mbetur vetëm Antarktida, veriu ekstrem i Amerikës dhe disa ishuj të Artikës dhe të oqeanit Paqësor. Por hapësira mjaft

të mëdha brenda kontinenteve kishin mbetur akoma si «njolla të bardha» ose paraqiteshin në harta në mënyrë skematike dhe me gabime. Nuk ishte zgjidhur «enigma e Nilit» (ku gjendet burimi i tij) asnjëri nga studiuesit nuk kishte hyrë thellë në pyjet e dendura të Afrikës tropikale, asnjëri nuk ishte ngjitur në majat e larta vullkanike të Kordiljerave të Amerikës Qendrore dhe Jugore, asnjë evropian nuk kishte përshkuar shkretëtirat dhe rrafshnaltat vigane të Azisë Qendrore. Malet e Azisë së Mesme, majat e të cilave arrijnë në lartësi mbi re, paraqiteshin nga gjeografët si vargje vullkanesh vepruese. Shumë udhëtarë dhe gjeografë kurreshtarë kishin dëshirë të madhe për të shkuar në këto krahina të panjohura plot fshehtësi, por jo edhe pa rrezeqe.

Këtë dëshirë kishte edhe Aleksandër Humboldti i ri. Ai lindi në Berlin në vitin 1769.

Aleksandër Humboldti dhe vëllai i madh i tij muarën një arësim të shëndoshë. Në Berlin Humboldtit iu ngjall një dëshirë e zjarrtë për studimin dhe mbledhjen e koleksioneve bimore të ndryshme. Ai shikonte me një interesim shumë të madh natyrën që kishte për rreth. Në fëmëni e quanin për shaka «farmacist»; që në atë kohë kishte kuptimin «dijetar».

Që në moshën 18 vjeç filloi të ndjekë mësimet në universitetet e Gjermanisë — në Frankfurt, Berlin, Getingen dhe pastaj studioi për inxhinieri minierash në akademinë minerare të Frajbergut.

Në atë kohë shumë të rinj kishin dëshirë të madhe për të bërë udhëtime. Ata thoshnin «Gjeografia është mbretëreshë e shkencave». Nuk i rrihej në një vend as Humboldt. Në vitin 1789 ai

bëri një udhëtim nëpër Gjermaninë Perëndimore dhe nëpër krahinat e Renit dhe shkroi veprën e tij të parë mbi bazaltet e Renit.

Vitin tjetër Humboldti shkoi për të parë Hollandën, Anglinë, Francën. Bashkudhëtari i tij, natyralisti Georg Forster kishte marrë pjesë në rini së bashku me babanë e vet në lundrimin e dytë rreth botës të Xhems Kukut. Në Londër Aleksandër Humboldti dhe Georg Forsteri u njohën me shkencëtarin Xh. Bëns, që kishte shoqëruar Kukun në lundrimin e tij të parë rreth botës.

Këto udhëtime dhe takime i shtuan akoma më shumë dëshirën Humboldtut për studimin e vendeve të largëta. Në vitin 1792 hyri në punë dhe u muar me problemet e minierave. Duke udhëtuar vazhdimisht nëpër minierat e Gjermanisë, Austrisë, Francës, ai studionte me kujdes njëkohësisht botanikën, zoologjinë dhe fiziologjinë. Kur ishte në Paris në vitin 1797, ai deshë të merrte pjesë në ekspeditën rreth botës të kryesuar nga kapiteni Bodën. Por ekspedita u shty. Humboldti dhe miku i tij Bonplan vendosën të niseshin në Afrikë. Por as këtë nuk mundën ta bëjnë. Atëhere ata shkuan në Spanjë, ku muarën leje nga qeveria për të studiuar natyrën e pronave spanjolle në Amerikën Qendrore dhe jugore.

Endërra e Humboldtut për të shkuar në vendet tropikale të Afrikës u realizua.

Në vitin 1799 Humboldti dhe Bonplani u nisën me anijen «Pisarro» prej skelës së Korunjës. Në ishujt Kanarie u ngjiten në vullkanin Teide.

Kur arritën në Venezuelë studiuan rrethet e qytetit Karakas dhe udhëtuan nëpër lianos.

Ja si e ka përshkruar Humboldti lianosin e Amerikës Jugore në kohën e thatë dhe me shi:





«Kur dielli në qiellin gjithënjë të kulluar djeg me rrezet e tij të pingulta barin e gjelbër dhe e bën pluhur, toka e tharë është me të çara të shumta si pas një tërmeti të madh... Ashtu siç ngrijnë në vendet e ngrira kafshët nga të ftohtit, po kështu krokodilat dhe boat, duke u futur thellë në argjilën e thatë, bien në letargji. Thatësira përhap në çdo anë vdekjen.

Më në fund pas një thatësire të madhe vjen stina e dëshiruar e shirave dhe pamja e stepës ndryshon shumë shpejt. Ngjyra e kaltërt në të errtë e qiellit, që deri në këtë kohë nuk ka qenë mbuluar nga asnjë re, merr ngjyrë më të hapur... Disa re të vetmuara ngrihen pingul mbi horizont dhe duken si male të largëta. Avuj të dendur, si mjergull, përhapen dalëngadalë deri në zenit. Oshëtimat e bubullimës lajmërojnë nga larg afrimin e shiut... Kur duket dielli mimosat barishtore hapin gjethet e tyre të rrahura nga shiu dhe në këtë mënyrë përshëndesin çfaqjen e këtij ylli ashtu siç e përshëndesin zogjt me këngën e tyre të mëngjezit dhe lulet e bimëve të kënetave me çeljen e tyre. Në këtë kohë kuajt, buajt shpërndahen nëpër stepë për t'u kënaqur me jetën. Bari i lartë fsheh jaguarin laraman, i cili i strukur në një vend të sigurt pret gjahun e tij. Kur kalojnë andej kafshë, ai, duke matur me sy madhësinë e kërcimit, hidhet mbi to si macet dhe si tigrat në Afrikë.

Sipas thënieve të vendasve në brigjet e kënetave argjila e lagësht nganjëherë ngrihet ngadalë dhe formon bregore. Pas një kohe të shkur-të dëgjohet një kërcitje e fortë dhe dheu hidhet lart, si atëhere kur zërthejnë vullkane të vogëla. Ai që e kupton këtë fenomen, ikën me vrap, mbase pas pak kohe del prej\_grope një gjarpër i tmerr-

shëm, uji ose një krokodil i koracuar, që zgjohet nga gjumi i tij letargjik pas shiut të parë. Dalëngadalë ngrihen dhe vërshojnë lumejt».

Gjatë studimit të këtyre vendeve, Humboldti dhe Bonplani lundruan në lundër me indianët gjatë lumejve Orinoko, Kasikiar, Rio-Negros që është degë e Amazonit.

Mbasi studiuan lianosin, udhëtarët shkuan në Kubë dhe prej andej në Peru. Mbasi arritën me vështirësi të mëdha deri në qytetin Kito, studiojnësit u ngjiten në vullkanet Kotopahi, Çimboraso etj., në shpatet e të cilave panë si ndryshojnë zonat e bimësisë sipas lartësisë.

Kur arritën në qytetin Lima, Humboldti dhe Bonplani u nisën me det për në Meksikë. Këtu qëndruan rreth një viti duke studiuar natyrën, popullsinë, ekonominë dhe kulturën e lashtë të këtij vendi. Më në fund vizituan skelën Verakruz, qëndruan në Havanë dhe prej gjirit Delaver (SHBA) morën rrugën e kthimit për Europë.

Udhëtimi zgjati pesë vjet. Rezultatet e tij që në shumë dobipruese për shkencën. Përpunimi i materialeve të mbledhura prej shkencëtarëve – shënimave, kolekcioneve, vizatimeve, përshkrimi i vetë-udhëtimit dhe botimi i tridhjetë vëllimeve me tabela dhe harta kërkoi 25 vjet punë.

Nganjëherë, duke ndërprerë punën në lidhje me materialet e ekspeditës, Humboldti udhëtoi nëpër vendet e Europës. Së bashku me gjeologun e njohur Leopold Buh dhe fizikantin Gei-Lysak, ai shkoi në Itali dhe u ngjit në Vezuv. Duke jetuar herë në Paris, herë në Berlin, ai nuk e ndërpreu punën shkencore, bile duke u marrë në mënyrë të posaçme me fenomenin e magnetizmit.

Për shumë kohë Humboldti ëndërroi të bën-

te një udhëtim në Indi dhe në arqipelagun e Malajës, por nuk ia doli të shkojë.

Në vitin 1829 me ftesën e qeverisë ruse Humboldt shkoi në Rusi për të bërë udhëtimin e tij të madh dhe të fundit. Në këtë kohë kishte mbushur 60 vjeç dhe njihej në gjithë botën si shkencëtar i madh.

Ai ishte zgjedhur vjete më parë anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Peterburgut dhe i Shoqërive shkencore ruse.

Në Rusi Humboldtin e interesonte sidomos grumbullimi i mahnitshëm i mineraleve të ndryshme në Ural dhe në Altai. Prej Peterburgut Humboldt shkoi në Moskë dhe prej këndej në Kazan, në Uralin e Mesëm, pastaj në Siberinë Perëndimore, në Uralin jugor, në Volgë deri në Astrakan dhe prej këndej përsëri në Moskë dhe në Peterburg. Në dhjetorin e vitit 1829 Humboldt u kthye në Gjermani.

Ekspedita në Rusi që e shkurtë, u bë në një hapësirë shumë të madhe dhe natyrisht, nuk mundi të japë rezultatet që dha puna në Amerikë, por megjithkëtë Humboldt botoi një sërë artikujsh dhe dy libra me përshkrimin e ekspeditës së tij.

Humboldt vdiq më 1859. Ai jetoi gjatë, 90 vjet. Duke patur një horizont shumë të gjerë, ky shkencëtar u muar me shkencat më të ndryshme: me matematikë, mekanikë, gjeologji, botanikë etj. Ai pa gjatë jetës së tij shumë vende dhe njohu nga afër njerëzit e shquar të kohës së tij — Gëten, Shilerin dhe shumë të tjerë. Humboldt që punëtor i palodhur gjatë gjithë jetës së tij. Ai thoshte se kishte fituar shprehinë të flinte vetëm 5 orë gjatë 24 orëve, duke ia kushtuar punës kohën tjetër.

Humboldt konsiderohet një nga themeluesit e gjeografisë së sotme. Ai u muar me gjithëfarë degësh të saj.

Në klimatologji Humboldt përcaktoi me saktësi ndryshimet e klimës detare dhe kontinentale. Ai gjeti metodën për të paraqitur veçoritë e klimës me anën e izotermave, që bashkojnë pikat me temperaturë të njëjlojtë. Ai krijoi në Gjermani një rrjet stacionesh meteorologjike për studimin e klimës. Sipas propozimit të tij në rrethet e Petersburgut u ngrit në Rusi observati i parë për studimin e magnetizmit të Tokës dhe për vrojtme të vazhdueshme në lidhje me fenomenet meteorologjike. Humboldt studioi rrymat detare. Ai i dha rëndësi të madhe studimit të fenomeneve elektrike në natyrë. Duke studiuar bimësinë e Amerikës dhe të vendeve të tjera, zbuloi një sërë specimesh të reja bimësh, shkroi një libër mbi gjeografinë e bimëve.

Duke studiuar relievin e rruzullit të Tokës, Humboldt paraqiti një metodë për gjetjen e lartësisë mesatare të sistemeve malore dhe të kontinenteve në tërësi. Ai studioi me kujdes të gjitha materialet në lidhje me relievin e Azisë së Mesme dhe Qendrore dhe formuloi hipotezën e tij mbi ndërtimin e këtyre sipërfaqeve kolosale. Më në fund, Humboldt dha shumë gjëra të reja në lidhje me pikëpamjet rreth ndërtimit të kores së dheut. Në kohën e tij në gjeologji luftonin dy kampe shkencëtarësh: disa — «neptunistët» — thoshnin se të gjithë shkëmbejt janë krijuar nga depozitimi i tyre në dete dhe oqeanë, disa të tjerë — «plutonistët» — mendonin se shkëmbejt kanë origjinë vullkanike. Në fillim Humboldt mbajti anën e «neptunistëve» por më vonë pranoi, siç ishte e vërtetë, se shkëmbejt janë krijuar në të dyja mënyrat.

Ai zbuloi disa minerale që nuk i njihje shkencë, shkroi shumë për mineralet e dobishme, sidomos për mineralet e Uralit.

Humboldti u përpoq gjithmonë të spiegojë ligjet e përgjithëshme gjeografike të natyrës. Ai përcaktoi i pari në malet e Amerikës zonalitetin vertikal të bimësisë dhe e përshkroi atë. Në librin e tij të shquar «Tabllora të natyrës» dha karakteristika të qarta të natyrës edhe sipas zonave të gjërësisë (pyje, stepa, shkretëtira etj.).

Humboldti e konsideronte gjeografinë në radhë të parë si një studim shkencor të vendeve. Si metodë të rëndësishme njohjeje shkencore gjeografike ai konsideronte krahasimin e natyrës të disa vendeve me natyrën e vendeve të tjera. Sipas mendimit të tij, gjeografia duhej të spiegonte këto lidhje si dhe ndikimin e disa fenomeneve dhe proceseve mbi fenomene dhe procese të tjera.

Humboldti thoshte se qëllimi kryesor i studimeve të tij në gjeografi ka qenë zbulimi dhe spjegimi i lidhjes së fenomeneve në natyrë. Kjo konsiderohet si një nga detyrat kryesore edhe në gjeografinë e kohës sonë.

Kështu, Humboldti i vuri bazat e studimit të sotëm fiziko-gjeografik të Tokës dhe gjeografisë shkencore krahinore.

Dëshira e Humboldtut për të gjetur dhe për të spieguar lidhjet universale në natyrë është shprehur në veprën e tij «Kosmos» në pesë vëllime. Ai punoi rreth saj gjatë gjithë veprimtarisë së tij shkencore. Në «Kosmos» Humboldti ka dashur të mbledhë dhe të përgjithësojë të gjitha zbulimet e shkencës së kohës së tij mbi natyrën e Gjithësisë.

Emri i Aleksandër Humboldtut si shkencëtar do të mbetet për gjithmonë në shkencën e gjeo-

grafisë. Emri i tij është shënuar në shumë vende në hartën gjeografike. Me emrin e tij është pagëzuar një vargmal në Azinë Qendrore, një lumë dhe një liqen në Amerikën Veriore, një vend në Kaliforni me qytetin Humboldt në gjirin e Humboldt, një akullnajë në Grenlandë, male në Australi, në Guinenë e Re dhe në Zelandën e Re si dhe disa specie bimësh, minerali humboldtit dhe, më në fund, një krater në Hënë.

Por shkenca eci aq shumë përpara, sa që shumë gjëra të shkruara në veprën «Kosmos» u vjetëruan që në shek. XIX. U vjetëruan disa teza të Humboldt në gjeologji si dhe teoria e tij mbi relievin e Tokës.

## **UDHËTIMI RRETH BOTËS I ÇARLS DARVINIT ME ANIJEN «BIGËLL»**

Në njerën nga ditët e vrenjtura të vitit 1831 luftania me dhjetë topa «Bigëll» e komanduar nga kapiteni Fic-Roa u nis prej brigjeve të Anglisë. Me këtë anije u nis ekspedita e admiralitit britanik, që duhej të përpilonte harta të hollësishme detare dhe të shënonte në to konturat e bregut lindor dhe perëndimor të Amerikës Jugore. Në këtë lundrim të gjatë rreth botës, përveç ekipazhit dhe oficerëve, u nis edhe shkencëtari i ri Çarls Darwin — natyralisti i madh i ardhëshëm.

Darvini lindi më 1809 në qytetin e vogël Shrubberi, që gjendet në Anglinë e mesme. Që kur ishte i vogël çfaqti dashuri të madhe për natyrën dhe dëshirë të zjarrtë për të mbledhur koleksione bimësh, insektesh, mineralesh etj. Ai lexonte shumë dhe i pëlqenin në një mënyrë të posaçme librat

e diturisë së natyrës sidomos me përshkrime udhë-  
timesh. Përshtypje të madhe i bëri libri «Mrekulli-  
të e botës». Ky libër ngjalli në të një dëshirë të  
zjarrtë për të udhëtuar.

Më vonë, kur hyri në universitet, Darvini stu-  
dioi thellë botanikën, gjeologjinë dhe zoologjinë.  
Ai mësoi të punojë në mënyrë të pavarur jo ve-  
tëm mbi librin, por edhe të bëjë vrojtime vetë në  
natyrë. Pas mbarimit të universitetit Darvini doli  
kandidati më i mirë për detyrën e natyralistit në  
ekspeditën rreth botës me anijen «Bigëll». Endë-  
rrat e Darvinit për udhëtim u realizuan. «Bigëlli»  
kaloi pa pengesë oqeanin Atlantik dhe në fund  
të shkurtit 1832 arriti në Brazil. Këtu Darvini pa  
për herë të parë pyllin tropikal. Kërkuesi i ri u end  
nëpër pyje, duke u habitur dhe duke u gëzuar me  
pasurinë e jashtëzakonshme të bimësisë tropikale,  
duke vërejtur dhe studiuar bimë të papara. He-  
shtjen e ajrit të nxehtë dhe të pyllit e prishnin vetëm  
fluturat vigane me fluturimin e tyre. Një herë Dar-  
vinin e zuri befasi në pyll stuhia tropikale, që i la  
një përshtypje të pashlyeshme.

Ndërsa oficerët e «Bigëllit» merreshin me ri-  
levimin kartografik të bregdetit të Amerikës Jugo-  
re, Darvini studioi vendet më interesante të kësaj  
pjesë të rruzullit të dheut. Ai shkoi në Uruguai,  
Argjentinë dhe Kili. Shkencëtari studioi natyrën dhe  
botën shtazore të pampës. Në kohën që Darvini  
udhëtonte nëpër pampë, atë e mbulonte një bar i  
dëndur i gjelbër. Nëpër pampë shiheshin kope të  
mëdha lopësh, kuajsh dhe delesh. Këtu Darvini  
u njoh me hauçosët — kombësi karakteristike e  
Amerikës Jugore, që ishte formuar nga përzierja e  
spanjollëve me indianë. Pamja e jashtëme e hau-  
çosëve i tërhoqi vemendjen; ata ishin të zhvilluar




Fig. 8. Harta e lundrimit të anijes «Bigëllë».



dhe të bukur, mbanin rrobe me ngjyrë të hapur, thika në brez, në çizme kishin yzengji shumë të mëdha, mbi shpatullat e hauçosëve binin flokë të gjatë kaçarelë.

Në pampë Darvini pa tufa me nga 20–30 krerë strucash nandu. Këta shpezë i linin kalorësit t'u afroheshin shumë dhe vetëm në çastin e fundit hapnin krahët dhe vraponin. Kurse thëllënxat plot besim, sipas thënieve të shkencëtarit, mund t'i vriste njeriu me shkop.

Darvini mbledhi një koleksion të madh kafshësh të pampës: disa gjitarë, 80 shpezë të ndryshme dhe shumë zvaranikë. Prej kafshëve të mëdha, interesant ishin një lloj dreri me erë të keqe. Darvini mësoi se në pampë drerët kishin frikë vetëm njerëzit që ecnin kaluar, nëqoftëse njeriu u afrohej duke u zvarritur, atëherë derët nga kureshtja i afrohen njeriut dhe përpiqen ta vërejnë. Në Amerikën e Jugut shkencëtari pa shumë brejtës. Këtu gjeti brejtësin më të madh në botë — derrin e ujit me një peshë rreth 40 kg. Derrat e ujit jetojnë në grupe të vogëla gjatë brigjeve të liqeneve dhe të lumenjve, duke ngrënë bimë ujëse.

Darvini përshkroi i pari në shkencë një brejtës tjetër karakteristik tuko–tukon, i cili jeton nën tokë, ashtu si urithi.

Më në jugë, në Patagoni, stepat e thata me bar këmbëshin me hapësira të mëdha pa ujë, të mbuluara me shkurre me gjëmba, thuaj se të pakalueshme për njeriun. Në disa vende sipërfaqen e rrafshinës e mbulonnte një shtresë e trashë zhavori. Bota shtazore ishte këtu mjaft e varfër.

Në bregun e oqeanit, në stepën e gjerë ly-more Darvini studioi jetën e çafkave, ndërsa në bregoret rërore vërejti jetën e grifonëve. Tek shkencëtari

ngjallën interes tatusët. Disa prej tyre kanë aftësi të zhyten me një shpejtësi të habitëshme në rërë, të tjerët të mbështillen menjëherë si top kur ndjejnë rrezik.

Në kepin e ulët Punta-Alta, që futet thellë në gjirin Baia-Blanka, Darvini zbuloi eshtëra kafshësh vigane të lashta tokësore. Sasia e këtyre eshtërave ishte këtu aq e madhe, sa që kepi dukej si një arkivol përbindëshash të vdekur. Shkencëtari gjeti mbeturinat e katër gjitarëve të mëdhenj me katër këmbë. Të gjithë ata u përkisnin formave barngrënëse, që kanë jetuar në erën terciare ose kuaternare. Darvinit i ra në sy se eshtërat e kafshëve u ngjanin eshtërave të egërsirave të sotme, por ishin shumë më të mëdhenj se këto. Atëherë në vetëdijen e shkencëtarit lindi pyetja: përse janë shuar të gjitha këto lama, përtacë? Shkencëtarja e kohës së tij nuk i jepte përgjigje kësaj pyetje.

Ky zbulim i shquar pati rëndësi shumë të madhe për tërë punën e ardhëshme shkencore të Darvinit. Kështu lindën në vetëdijen e shkencëtarit mendime, që ai i zhvilloi më vonë dhe përbënë bazën e teorisë së tij të evolucionit.

Në rrugën që shpinte në Buenos Ajres shiheshin qytete të vogëla të zhytura në gjelbërimin e kopshteve. Darvini vërejti me interes thertoret, që sipas fjalëve të tij, përbënin kuriozitetin kryesor të kryeqytetit të Argjentinës — Buenos Ajresit.

Duke shkuar në Tokën e Zjarrtë «Bigëlli» qëndroi në ishujt Folkland. Vemendjen e dijetarit e tërhoqën pinguinët, që zhyteshin me shkathtësi dhe shpejtësi në ujë për të kapur peshk. Darvini u përpoq të largojë njërin nga pinguinët nga deti, por ndeshi në rezistencë këmbëngulëse të shpezës që donte të shkonte drejt ujit.

Lundëtarët arritën në Tokën e Zjarrtë në verë. Këtu temperaturat e ajrit rralë herë kapërcente 7° dhe thuajse çdo ditë binte shi ose dëborë. Pyjet prej ahuj, që mbulonin shkëmbejt e rrumbullakosur, ishin të pakalueshme. Banorët vendas të ishullit ishin veshur vetëm me guna prej lëkure të guanakos me lesh përjashta, megjithëse bënte të ftohtë.

«Bigëll» arriti tek kepi i njohur Horn. Ishte një mot i qetë, që ndodh rralë në këto vise. Rrugat për në oqeanin Paqësor kalonte nëpër njerin nga kanalet e ngushticës së Magelanit. Duke dredhuar me shkathtësi midis gurëve të panumërt, «Bigëlli» hyri në hapësirat e oqeanit dhe arriti në Valparaizo – port kryesor detar i Kilit. Nëpër mjegullirën e lehtë të kaltërt të ditës plot diell shqueshin majat madhështore me dëborë të Andeve.

Darvini bëri disa ekskursionet në Andë. Gjatë rrugës pa kushtet e vështira të punës së minatorëve në minierat e bakrit dhe vendburimet e arit. Në Kili udhëtari pati rast të shohë shpërthimin e vullkanit Osorno, drita e kuqe e ndezur e të cilit pasqyrohej edhe në ujrat e oqeanit. Kurse në qytetin Valdiv Darvini provoi një tërmet të madh. Në çastin e rënies së tërmetit ai pushonte në një pyll afër bregut të detit. Tërmeti zgjati dy minuta. Ndiujimet e lëkundjeve të para Darvini i krahasoi me lëkundjen e anijes nga tallazet e lehta anësore ose me ato ndiujime që provon njeriu, duke shkarë nëpër akull të hollë, që përkulet nën peshën e tij. Pamje më të tmerrshme pa kapiteni Fic-Roi, i cili gjendej në qytet në kohën e tërmetit.

Darvini e vazhdoi udhëtimin e tij gjatë bregut të Kilit derisa ia preu rrugën në veri shkretëtira pa ujë e Atakamës. Këtu pa vendburimet e njobura të salpetërit të Kilit. Në minierë shkohej në-

për një rrugë përmes shkretëtirës, të mbuluar me një shtresë të trashë kripe të bardhë gjelle dhe gipsi, që dukej si dëborë e shkrirë e ndotur. Vende-vende nëpër rërë shiheshin likene me ngjyrë të verdhë të zbetë. Kudo shiheshin kufoma të tharta dhe eshtëra kafshësh të ngordhura.

Shtresat e nitratit të natriumit gjendeshin afër sipërfaqes së tokës dhe shfrytëzoheshin hapur, pa galeri.

Mbasi u largua nga brigjet e Amerikës Jugore «Bigëll» u drejtua nga arqipelagu i Galapagos që gjendet pikërisht në Ekuator, ishujt e të cilit janë të mbuluar me lavë të zezë bazalti. Nga krateret e disa vullkaneve ngriheshin shtëllunga avulli. Çdo gjë për rreth kishte gjurmën e shpërthimit që kishte ndodhur para një kohe të shkurtë. Në shkëmbenjtë e zyrtë rriteshin vetëm shkurre të fishkura, akacie dhe kaktuse të vetmuara. Nëpër ishuj jetonin breshka vigane që peshonin mbi 150 kg. Darvini provoi fuqinë e një breshke, duke i hipur në shpinë. Breshka e ngriti pa zor dhe e mori me vete. Në këta ishuj jetonin shumë shpezë si dhe mishngrënës që ishin të afrueshëm.

Pas një udhëtimi të gjatë nëpër hapësirat e pafundme të oqeanit Paqësor «Bigëll-i» arriti në ishullin Taiti dhe pastaj në Zelandën e Re, ku prej këtej u drejtua në Australi. Darvini u ngjiti në Malet e Kaltra. Rruga nëpër këto male kalonte nëpër pyje eukalipti, nëpër shkretëtirë, nëpër një fushë pak të valavitur, të mbuluar me tufa bari të murmë, të ashpër, që është një ushqim shumë i mirë për dhent.

Prej Australie «Bigëll-i» u drejtua nga brigjet e Europës. Gjatë rrugës anija qëndroi në ishujt e vegjël, të shpërndarë midis hapësirave oqeanike.

Darvini përcaktol origjinën vullkanike të dësave prej tyre. Ai studioi ishujt koraliane dhe formuloi teorinë e lindjes dhe të zhvillimit të tyre. Kjo teori konsiderohet edhe sot si teoria më e drejtë.

Lundrimi i «Bigëll-it» rreth botës zgjati pesë vjet. Në vjeshtën e vitit 1836 Darvini u kthye në Angli, ku jetoi pa u larguar thujtë fare deri në fundin e jetës së tij. Rezultatet vrojtive të tij shkencëtarit i parashtrroi në librin e njohur «Udhëtimi i një natyralisti rreth botës me anijen «Bigëll». Përveç kësaj, ai shkroi shumë vepra shkencore në lidhje me zoologjinë, botanikën, gjeologjinë dhe shkencat e tjera, duke përgjithësuar materialet e vrojtive të tij gjatë ekspeditës.

Gjatë lundrimit me anijen «Bigëll» tek Darvini u formuan pikëpamje të reja mbi historinë e zhvillimit të jetës në Tokë. Veprat shkencore të tij bënë revolucion në shkencat e natyrës dhe u dhanë një goditje çkatërrimtare ideve fetare mbi krijimin e botës dhe pandryshueshmërinë e bimëve dhe të kafshëve. Darwinizmi është një fitore shumë e madhe e njerëzimit, që i vuri themelet biologjisë së sotme shkencore.

Çarls Darvini vdiq më 1882. Deri në ditët e fundit të jetës së tij ai e ruajti aftësinë për punë si dhe qartësinë e mrekullueshme mendore.

## **DAVID LEVINGSTON STUDIUESI I AFRIKËS**

Në shek. XV–XVI gjatë brigjeve të Afrikës lundronin vetëm anijet portogjeze. Në shek. XVII kolonitë portogjeze në bregun perëndimor dhe lindor të këtij kontinenti u pushtuan prej koloniza-

torëve holandezë. Kolonizatorët holandezë u vendosën në kepën e Shpresës së Mirë dhe dalëngadalë filluan të depërtojnë në thellësitë e kontinentit

Në shek. XVIII dolën në skenë kolonizatorë të rinj – francezët dhe pastaj anglezët. Skocezi Brus arriti në burimet e Nilit të Kaltërt, ndërsa Mungo Parku u fut në thellësi të këtij kontinenti nëpër lumejt Gambia dhe Niger.

Në vitin 1781 qeveria engleze vendosi të shtinte në dorë koloninë e Kapit. Për këtë vend Anglia kishte luftuar 35 vjet me Francën dhe me Hollandën, derisa nuk ishte vendosur në bregun jugor të Afrikës. Pas kësaj udhëtarët anglezë (Kempbell, Mofet, Vardon etj.) filluan të depërtojnë nga jugu tek burimet e lumit Oranzh, në vendet e banuara nga beçuanët dhe zulutë. Pas tyre shkolin misionarët për t'u predikuar zezakëve krishtërimin, d.m.th. nënshtrimin ndaj të bardhëve. Klerikët ashtu si në çdo kohë dhe në çdo vend dhe këtu kanë luajtur një rol negativ. Ata vazhdimisht kanë predikuar «paqen» në mes popujve të nënshtruar dhe shtypësve, në mes shfrytëzuesve dhe të shfrytëzuarve.

Pas gjurmëve të tyre shkolin njësitë ushtarake, që vendosnin sundimin anglez mbi zezakët.

Për popujt e Afrikës këto kanë qenë vjete të tmerrshme. Kolonizatorët dhe tregëtarët e skllëvërve anglezë filluan t'i gjuanin zezakët si kafshët e egra. Ata i kapnin, i lidhnin në pranga dhe i çonin me grupe shumë të mëdha në portet detare. Prej këndeje i nisnin për Amerikë, Turqi, Arabi dhe Persi, duke i futur në hambaret e anijeve, për t'i shitur në tregjet e skllëvërve.

Midis udhëtarëve dhe studiusëve të Afrikës kishte, natyrisht, mjaft njerëz të ndershëm, që vi-

nin këtu për qëllime shkencore. Disa prej tyre u përpoqën të mbronin vendasit nga skllavëruesit. Por protestat e njerëzve të vetmuar ishin si zëri në shkretëtirë dhe nuk mund të ndalonin sjelljen mizore të kolonizatorëve kundër vendasve.

Një nga këta studiues të Afrikës — kundërshtar i skllavërimit të zezakëve — ka genë anglezi David Levingstoni. Ai lindi në një familje të varfëruar fermeri, që u detyrua të shpërngulet dhe të vendoset në zonën industriale afër Glazgout. David Levingstoni e kaloi fëmëhinë në kushte shumë të vështira. Që në moshën 10 vjeç filloi të punojë në fabrikë. Që nga ora gjashtë e mëngjezit dhe deri në orën tetë të mbrëmjes punonte mjaft rëndë dhe pas punës vazhdonte dy orë mësim në shkollën e natës. Natën dhe nganjëherë edhe në kohën e punës, fshehurazi nga mjeshtri, djaloshi lexonte me etje të madhe «...Unë si të thuash i gëlltisja librat, — çdo gjë që më binte në dorë, me përjashtim të romaneve. Trillimet nuk më pëlqenin. Por çdo gjë që kishte të bënte me çështje shkencore dhe sidomos me udhëtime, e lexonja me kënaqësi të madhe», — ka thënë më vonë Levingstoni.

Të djelave Levingstoni bënte shetitje të gjata rreth fabrikës, mbledhte koleksione minëralesh, kërkonte fosile në gurore, përgatiste herbariume. Këto ekskursionë ia shtuan dashurinë për natyrën, gjithënjë e më tepër i shtojë dëshira për studime shkencore.

Kur mbushi 19 vjetët Levingstoni u bë pël-hurendës, kurse pas punë ndiqte kurset e mjekësisë. Ai arriti të mbarojë mjekësinë dhe të bëhet mjek. Por mjeku me origjinë punëtores nuk mund të gjente punë në Angli. I mbetej vetëm një rrugë — të largohej nga atdheu. Në këtë kohë shumë

të rinj shkonin prej Anglie në kolonitë e largëta për të kërkuar punë.




Fig. 9. Itinerari i udhëtimit të D. Livingstonit.

Në vitin 1840 ai u nis në Afrikë, në kepën e Shpresës së Mirë. Prej skelës Akgoa Livingstoni hyri në vendin e beçuanëve. Prej këndej Livingstoni filloi udhëtimin shumëvjeçar nëpër kontinentin e Afrikës. Atë e interesonte jeta e popullsisë zezake, natyra, bota bimore dhe shtazore. Livingstoni kaloi shumë aventura të rrezikshme. Kështu, një herë për pak e copëtoi një luan; ai mbeti sakt në dorën e majtë për tërë jetën.



11 Në vitin 1849 ai përshkoi shkretëtirën Kala-hari dhe zbuloi liqenin Ngami, të cilin nuk e kishte parë asnjë europian më parë. Vitin tjetër Levingstoni u nis tutje më në veri, nga rrjedha e sipërmë e lumit të madh Zambezi. Këtu vështroi për herë të parë si gjuheshin zezakët prej tregëtarëve të skllëvërve dhe e urrejti për tërë jetën skllavërinë. Kudo ku mundi ai u ngrit kundër tregëtarëve të skllëvërve, duke vënë disa herë edhe jetën e tij në rrezik.

Në vitin 1852 Levingstoni u nis në një udhëtim të gjatë prej zonave qendrore të Afrikës jugore në drejtim të brigjeve të oqeanit Atlantik. Me 33 lundra ekspedita u ngjit nëpër lumin Zambezi. Rrugë kalonte nëpër pronat e disa fiseve zezakë. Kryetarët e fiseve kërkonin shpërblim për kalim. Levingstoni u detyrua të shpenzojë thuajse gjithë pasurinë e tij. Duke kapërcyer vështirësi shumë të mëdha, i dërmuar nga ethet, ai arriti në bregun e Atlantikut, duke kaluar nëpër ujëndarjen e Zambezit dhe të Kongos. Me gjithë këshillat këmbëngulëse, që të kthehej menjëherë për shërim në Angli, Levingstoni nuk u tërhoq; ai u kishte dhënë fjalën shoqëruesve të tij se nuk do t'i braktiste në rrugë, por do t'i çonte në fshatrat e tyre. Dhe e mbajti fjalën e dhënë. Vetëm mbasi i siguroi ata, ai u kthye në Angli.

Gjatë udhëtimit ai studiòi i pari dhe shënoi në hartë rrjetin lumor të Afrikës Jugore dhe përcaktoi ujëndarjen midis pellgjeve të lumënjeve Zambezi dhe Kongo.

Në vitin 1855 ai u nis përsëri nëpër lumin Zambezi, por në drejtim tjetër, në drejtim të rrjedhjes së lumit. Pas një udhëtimi prej dy javësh Levingstonit i doli përpara një ujëvarë madhështore.

Gjerësia e Zambezit në këtë vend kapërcen kilometrin, uji bie në një humnerë prej më se 100 m. Zezakët e quajnë këtë ujëvare «tym udhëtues», mbasi mbi të qëndron vazhdimisht një shtyllë spër-kash uji. Këtë kaskadë nga më të mëdhat në botë Levingstoni e pagëzoi me emrin Viktoria.

Në vendet, ku nuk mund të lundrohej, udhëtarët ecnin më këmbë gjatë brigjeve të Zambezit, duke çarë rrugën me vështirësi të madhe nëpër pyjet e heshtura dhe të lagështa tropikale. Levingstoni doli në bregun e oqeanit Indian, duke i dhënë fund një udhëtimi që zgjati gadi katër vjet. Ai që i pari midis evropianëve që kaloi prej një ane në tjetrën të Afrikës Jugore dhe që shënoi në hartë lumin Zambezi. Vrojtimet që bëri Levingstoni gjatë udhëtimit, e çuan në konkluzionin e drejtë në lidhje me ndërtimin e përgjithshëm të relievit të krejt Afrikës Jugore. Ai e konsideronte atë të ngjashëm dhe një pjatë të sheshtë me buzë të ngritur, që bijnë thikë në oqean.

Mbasi qëndroi 10 vjet në Afrikë, Levingstoni u kthye në Angli. Por pas një viti, më 1858, udhëhoqi një ekspeditë që u dërgua për të studiuar Afrikën Lindore dhe Qendrore. Kësaj radhe, duke kaluar nëpër degën e Zambezit — lumin Shir, Levingstoni mori drejtimin nga veriu dhe zbuloi liqenin e madh Niasa dhe liqenin Shirva. Këtu ai vërejti përsëri gjuetinë e zezakëve nga skllavopronarët. Ai pa gjithashtu se tregëtarët e skllëve nuk ndaleshin para asnjë mizorie: masakronin fëmijë, digjnin e shkretonin çdo gjë. «Ngado që shkonim, — shkruan Levingston-i me zemrim — në të gjitha anët shikonim skelete njerëzish».

Në vitin 1864 Levingstoni u kthye në Angli. Mbasi qëndroi pak, filloi të pregatitet për një ek-

speditë të re. Ai donte të shkonte tek burimi i Nilit. Levingstoni vizitoi përsëri liqenin Niasa. Studioi liqenin e madh të Tanganikës dhe zbuloi liqenin Bangveulu. Ky udhëtim qe jashtëzakonisht i vështirë. Levingstonit i ndodhën fatkeqësitë njëra pas tjetrës. Që në fillim të udhëtimit i ikën disa zezakë që mbante me vete, iu zhdukën dhitë, me qumështin e të cilave ushqehej udhëtari i sëmurë. Përveç etheve që e kishin raskapitur, e kapën edhe sëmundje të tjera. Në fund Levingstoni u dobësua aq shumë, sa që zezakët u detyruan ta mbanin në vig.

Për të marrë veten, Levingstoni u detyrua të qëndronte në Uxhixhi, që ishte qendër e tregëtisë së sklleverve. Një ditë, kur Levingstoni me shpirt në dhëmbë po mendonte për gjendjen e tij të pashpresë, në kasollën e tij hyri me vrap një zezak dhe i tha se po afrohej një karvan i panjohur. Kjo ishte ekspedita e Henri Stenlit, që e kishte dërguar botuesi i gazetës «Nju-Jork herald» për të kërkuar Levingstonin.

Ndihma që iu dha me kohë, e shpëtoi Levingstonin nga vdekja. Por kur i tha Stenli të largohej nga Afrika, Levingstoni refuzoi në mënyrë të prerë. Pas pak kohe ai u shërua dhe së bashku me Stenlin studioi liqenin e Tanganikës.

Në udhëtimin e tij të fundit rreth liqenit Bangveulu Levingstoni u nis më 1872. Edhe ky qe një udhëtim i vështirë: duhej kaluar nëpër vende me kënetë e me plot bimë barishtore, që mbulonin brigjet e liqenit, duke u zhytur shpesh herë deri në brez në ujë. Shëndeti i Levingstonit ishte rrënuar dhe këtu u sëmur rëndë. Në këtë vend, në bregun e liqenit Bangveulu, që e kishtë zbuluar dhe studiuar, ai vdiq në vitin 1873.

Levingstoni ka qenë një mik i vërtetë i popujve të Afrikës. Shoqëruesit e donin dhe e nderonin. Të gjitha ditaret dhe materialet e mbledhura prej shkencëtarit gjatë udhëtimit, afrikanët i ruajtën. Ata varrosën në tokën e tyre zemrën e udhëtarit, ndërsa trupin e balsamuar e mbajtën 9 muaj në duar për ta çuar në portin Zanzibar, ku e mori një vapor për ta çuar në Angli.

Si para ashtu dhe pas tij as njëri tjetër nuk bëri aq shumë zbulime gjeografike në Afrikë sa Levingstoni.

Levingstoni ishte mbrojtës i popujve të Afrikës. Ai luftoi kundër tregëtarëve të skllëvërve për të ndaluar «gjuetarët e njerëzve», që donin të pasuroheshin në çdo mënyrë. Shpesh herë ai protestoi në qeveri. Nën presionin e Levingstonit qeveria angleze u detyrua të ndalojë formalisht tregëtinë e skllëvërve në Zanzibar, por përpjekjet e udhëtarit të madh, natyrisht, nuk mundën të ndalojnë kolonizimin dhe ndarjen e kontinentit afrikan nga imperialistët.

## **NIKOLLAJ NIKOLLAJEVIÇ MIKLUHO-MAKLAI**

Udhëtari i palodhur, studjues i popujve «të egër», luftari i paepur për të vërtetën shkencore mbi barazinë e njerëzve, patrioti i zjarrtë Nikollaj Nikollajevič Mikluho-Maklai, pati jetë të shkurtër, por të ndritur. Ai gjithë jetën ia kushtoi studimit të natyrës dhe popujve që banonin në vendet tropikale dhe në ishujt e oqeanit Paqësor. Fjala e re e Mikluho-Maklait në shkencën e njeriut ushtoi në tërë botën, pati jehonë midis shkencëtarëve

përparimtarë dhe ngjalli urrejtjen ndaj tij në qarqet shkencore dhe politike reaksionare.

Mikluho-Maklai lindi në një fshat pranë qytetit Boroviçi më 1846. I ati ishte inxhinier. Në moshën 11 vjeç Mikluho-Maklai filloi shkollën filllore, pastaj vazhdoi Gjimnazin e shtetit në Peterburg. Mbas mbarimit të shkollës së mesme hyri në fakultetin e fizikës dhe matematikës të universitetit të Peterburgut. Ai iu përvesh me kënaqësi të madhe studimit të shkencave të natyrës dhe krahas me to veprave të demokratëve të mëdhenj: Hecenit, Bjelinskit, Çernishevskit, Dobroliubovit e Pisarevit.

Pa mbushur një vit djaloshi «i padëshiruar» u përjashtua nga universiteti për pikëpamjet e tij demokratike pa të drejtë që të ndiqte mësimet në shkollat e tjera të larta të Rusisë. Mikluho-Maklai tetëmbëdhjetë vjeçar u detyrua kështu të largohet nga atdheu dhe të fillojë endjet jashtë atdheut.

Në Gjermani në fillim ndoqi mësimet në fakultetin e filozofisë së Hajdelbergut, pastaj në fakultetin e mjekësisë në Lajpcig dhe Jena. Këto kanë qenë vjete studimesh intensive dhe varfërie të madhe. Në letrat që dërgonte në atdhe, ai shkruante: «... me të vërtetë nuk di si të jetoj, mezi kam mundur të meremetoj xhaketën. Po të keni mundësi, më dërgoni penjë dhe kopsa».

Vetëm vendosmëria dhe vullneti i çeliktë i dhënë mundësi të kapërcejë këtë gjendje.

Mikluho-Maklai u dha tepër pas teorisë së Darvinit. Ai mori pjesë në ekspeditën shkencore në ishujt Kanarie dhe në Marok si ndihmës i natyralistit të njohur prof. E.Hekel, që ishte propagandues i ideve të Darvinit. Vrojtimet në lidhje me popujt e Afrikës dhe të ishujve të Atlantikut, që

ishin robëruar prej europianëve, përcaktuan përfundimisht drejtimin e veprimtarisë shkencore të Mikluho-Maklai.

Ai filloi të bëjë studime vetë. Me mjete të pakta, pa ndihmës Mikluho-Maklai u nis në bregun e detit të Kuq. Mësoi gjuhën arabe dhe duke u veshur si vendas, bëri udhëtime të rrezikshme. Mikluho-Maklai studioi botën bimore dhe shtazore të detit të Kuq dhe jetën e popujve, që banonin në brigjet e tij.

Mbasi u kthye në Rusi, Mikluho-Maklai mbajti në Shoqërinë gjeografike të Pëterburgut një referat mbi studimet e tij dhe paraqiti një projekt për një ekspeditë të madhe në ishujt e oqeanit Paqësor. Atje shpresonte të gjente përgjigje për shumë çështje që e interesonin atë mbi zhvillimin e botës shtazore të detrave dhe kryesisht për çështjet e origjinës dhe të zhvillimit të racave njerëzore.

Në ato vjete zhvillohej një luftë e ashpër në shkencë në lidhje me origjinën e njeriut — antropologjinë. Shkencëtarët më përparimtarë — «monogjenistët» thoshnin se të gjithë njerëzit, pavarësisht nga ndryshimet raciale, kanë lindur prej të parësh të përbashkët.

Shkencëtarët reacionarë — «poligjenistët» përpiqeshin të provonin se racat njerëzore kanë origjinë të ndryshme. Ata thoshnin se njeriu i bardhë dhe njeriu i zi janë dy lloje të ndryshme, po aq të pangjashme si bufi dhe shqiponja. Këndej nxirrej konkluzioni se racat kanë vlerë të ndryshme. Raca e bardhë është caktuar, gjoja, nga natyra për sundim, kurse raca e zezë nuk mund të zhvillohet dhe është destinuar të nënshtrohet.

Mikluho-Maklai, ishte partizan i monogjenistëve. Ai mendonte se raca e bardhë, e verdhë, e

zezë kanë një origjinë, kanë aftësi të njëllojta për zhvillim kultural dhe ekonomik. Nuk ka raca «të larta» dhe «të ulta». Për të provuar se ishte kështu Mikluho—Maklai vendosi të fillojë studimet shkencore duke studjuar popujt «primitivë», që banojnë në ishujt tropikalë.

Shoqëria gjeografike ruse e ndihmoi shkencëtarin e vendosur dhe energjik. Atij iu dhënë shumë e vogël të hollash dhe Shoqëria gjeografike ruse nxorri lejen për të dërguar Mikluho—Maklain me anijen ushtarake ruse «Vitiaz» në ishullin e Guinesë së Re.

Anija «Vitiaz» u nis prej Kronshtadtit në vjeshtën e vitit 1870, arriti në brigjet e Brazilit, kaloi për rreth Amerikës Jugore dhe arriti në Valparaiso; prej këndej Mikluho—Maklai bëri një udhëtim në Santiago dhe në malin Akonkago. Pastaj anija «Vitiaz» u drejtua nga ishulli i Pashkëve, vazhdoi në drejtim të ishujve Samoa dhe Guine e Re. Në ishullin Upalu (Samoa) Mikluho—Maklai mori në shërbim suedezin Uillson dhe polinezianin Boja. Gjatë rrugës udhëtari bënte kudo vrojtime shkencore dhe herë pas here ia njoftonte me letra Shoqërisë gjeografike.

Pas 316 ditë udhëtimi Mikluho—Maklai zbriti në bregun e Guinesë së Re midis pyjeve të dendura tropikale, ku jetonin papuanët — njerëz të «kohës së gurit».

Nga madhësia e sipërfaqes ishulli i Guinesë së Re është ishull i dytë në botë — pas Grenlandës. Në thellësinë e tij ngrihen male që arrijnë deri 4500 m. Pjesa më e madhe e ishullit ishte e mbuluar me pyje tropikale të pakalueshme.

Atje rriten palma të ndryshme, hurma etj. ndërsa gjatë brigjeve rriten druj karakteristikë. Në

ishull nga kafshët më të përhapur janë derrat e egër, qent e egër, minjtë, hardhuca shumë të mëdha, kurse nëpër lumenj jetojnë me shumicë krokodilat. Nëpër pyje enden sasira të mëdha shpezësh: papagaj, pëllumbat etj. Këtu ka shumë lloj fluturash, bile disa prej tyre i kanë krahët e shtrirë deri 20 cm.

Vendasit, papuanët, merreshin kryesisht me gjueti dhe peshkim. Mikluho-Maklai e përshekruan kështu çfaqjen e tij në një fshat papuan:

«Një grup njerëzish të armatosur me heshta qëndronte në mes, duke folur me gjallëri, por me zë të ulët. Të tjerët, të gjithë të armatosur, qëndronin më larg. Nuk shiheshin as gra, as fëmijë, me sa duket ishin fshehur. Kur më panë, disa vendas ngritën heshtat, ndërsa të tjerët muarën një qëndrim shumë luftarak, sikur të përgatiteshin të hidhnin heshtat... I lodhur, pjesërisht i habitur nga pritja e papëlqyeshme, unë vazhdova të ecja ngadalë. M'u afruan disa vendas. Befas fluturuan shumë afër meje dy shigjeta të hedhura me qëllim ose pa qëllim. M'u duk se vendasit donin të dinin si do të silleshin kur të shikoja shigjetat e hedhura shumë afër meje... Një grumbull i vogël më rrethoi: dy tre veta flisnin me zë shumë të lartë, duke më shikuar me një farë armiqësie. Në këtë rast, sikur donin t'i theksonin më shumë fjalët e tyre, ata lëvizin heshtat. Njëri prej tyre u lëshua befas me heshtë dhe gati më qëlloi në sy ose në hundë. Unë u largova nja dy hapa anash dhe munda të dëgjoj disa zëra, të cilat (siç m'u duk, ndoshta m.ua) e dënuan këtë veprim...

Pa u menduar gjatë, gjeta një vend në hie, hapa një hasër të re dhe u shtriva në të me kënaqësinë më të madhe. Unë vura re se vendasit u vendosën në një gjysmë rrethi në një farë largë-



sie nga unë, me sa duket, duke u habitur dhe duke u përpjekur të marrin me mend çdo të ndodhë më vonë. Fjeta nja dy orë e ca. Kur hapa sytë, pashë disa vendas. Ata ishin pa armë dhe më vrenin diçka më butë. Pastaj u ngrita dhe u nisa po nëpër atë shteg nga kisha ardhur».

Ky takim i bindi vendasit se udhëtari ishte njeri paqdashës dhe midis tyre u vendosën marrëdhëniet më miqësore. Papuanët i sollën Mikluho-Maklajt banane, arra kckosi, kallam sheqeri.

Mikluho-Maklaj jatoi më se një vit midis papuanëve të Guinesë së Re. Ai nuk e fitoi miqësinë e tyre me armë, me detyrim, por me durim dhe me vepra të mira, me ndihmë dhe këshilla. Duke studiuar jetën e banorëve të këtij ishulli, duke njohur për së afërmi shumë prej tyre, Mikluho-Maklaj u bind gjithënjë më shumë për aftësinë e këtyre njerëzve «primitivë», për zhvillim mendor dhe për absurditetin e «teorisë» së racave «të ulta».

Nëpër vendet e qytetëruara u përhap lajmi se Mikluho-Maklaj ishte zhdukur. Por anija «Izumrud» që u dërgua për zbulim, e gjeti shkencëtarin. Mikluho-Maklaj ishte sëmurë nga malaria tropikale, e cila kishte çuar në varr njerin nga bashku dhëtarët e tij.

Mbasi u shërua Mikluho-Maklaj u kthye prapë në Guinenë e Re. Ai studioi dhe krahasoi tipat e njerëzve dhe jetën e banorëve të Guinesë lindore dhe perëndimore. Kur zbriti në pjesën tjetër të Guinesë së Re, Mikluho-Maklaj gjeti këtu papuanë, të cilët i njihnin kolonizatorët europianë. Kur arriti në ishullin e Javës, në Batavia (Xhakarta e sotme), Mikluho-Maklaj botoi konstatimet e tij rrebi gjendjen e mjeruar të popujve, të Guinesë së Re, si rezultat i veprimtarisë «qytetëruese» të ko-

Ionizatorëve europianë, të cilët kishin robëruar dhe çfarosur papuanët.

Më 1874–1875 Mikluho–Maklai bëri dy udhëtime në brendësinë e gadishullit të Malakës për të krahasuar popujt që banonin atje me papuanët. Para tij askush nuk kishte parë «njerëzit e pyllit» të gadishullit të Malakës. 113 ditë udhëtim nëpër kënetë, xhungla, midis fiseve të panjohura vendase, i dhanë udhëtarit material shumë të pasur shkencor. Mbase u kthye në Batavia, ai botoi veprën e parë shkencore mbi fiset e Malakës.

Më 1876 Mikluho–Maklai vizitoi ishujt Admiral dhe pastaj shkoi përsëri në Guinenë e Re. Këtu e pritën me gëzim miqt–papuanë. Ai jetoi me ta edhe 17 muaj.

Më 1879–1881 Mikluho–Maklai lundroi me një anije me vela amerikane në ishujt e Mellanezisë dhe të Australisë, ku organizoi një stacion shkencor detar afër qytetit të Sidneit.

Më 1882, pas 12 vjet udhëtime, Mikluho–Maklai u kthye në atdhe. Pothuajse të gjitha gazetat e Peterburgut lajmëruan ardhjen e tij. Shoqëria gjeografike ruse i përgatiti një pritje të ngrohtë Mikluho–Maklajt. Pas fjalëve të nxehta të P.P.Seminov–Tjanshanit, e mori fjalën udhëtarit trim. Në tregimin e tij të qetë dëgjohej e vërteta e madhe e jetës dhe bindja për vlerësimin e barabartë të të gjitha racave dhe të të gjithë popujve.

«Ndikimi im në vendasit që aq i madh, — vuri në dukje Mikluho–Maklai, sa që arrita të ndaloj kreyt luftat vëllavrasëse. Ky rezultat më dha kënaqësinë më të madhe».

Përsëri lindi dëshira për të vizituar popujt primitivë.

Në vitin 1882 Mikluho-Maklai u nis tek miqtë e tij në Guinenë e Re, duke mbajtur gjatë rrugës referate në Berlin, Paris dhe Londër. Kësaj radhe ai u sollli miqve të tij papuanë tri krerë gjedh, dhi, lëkura, pëlhura, ruaza, pasqyra dhe shumë farrëra bimësh të dobishme. Ky qe udhëtimi i fundit i shkencëtarit tek papuanët. Vendasit e lutën Mikluho-Maklain të qëndronte, por ai kishte plane të tjera.

Në Sidnei i dha fund organizimit të stacionit biologjik, duke qëndruar këtu deri në shkurtin e vitit 1886. Prej këndej ai i drejtoi një letër qeverisë së carit, duke i propozuar të merrte nën protektorat të Rusisë teritorin e Bregut të Maklait. Por qarqet zyrtare të Rusisë cariste e refuzuan këtë propozim.

Mbasi u kthye në Peterburg, Mikluho-Maklai bëri thirrje në gazeta për të shkuar në Bregun e Maklait për të themeluar një koloni ruse. Ai mendonte të organizonte një koloni në bazë të ekonomisë së përbashkët, pa pronësi tokësore, pa sistem monetar, pa xhandarmëri dhe polici.

Thirrjes së Maklait iu përgjigjën me shpejtësi mbi 2000 veta. Por për organizimin e kolonisë nevoiteshin mjete. Mikluho-Maklai vendosi të botojë veprat dhe ditaret e tij dhe për këtë qëllim shkoi për të marrë materialet në Sidnein e Australisë dhe pastaj u kthye me familjen e tij në Peterburg.

Nga fundi i vitit 1884 u tha se Gjermania kishte vendosur të pushtonte Bregun e Maklait dhe ta shpallte koloni të saj. Mikluho-Maklai i sëmurë rëndë i dërgoi një telegram proteste Bismarkut: «Vendasit e Bregut të Maklait kundërshtojnë aneksimin e tyre me Gjermaninë».

Mikluho-Maklai vdiq më 1888 në moshën 42-vjeç, pa arritur të botojë veprat e tij kryesore shkencore.

U bënë përpjekje të mëdha që të botoheshin veprat e udhëtarit të shquar rus, por as Shoqëria gjeografike, as Akademia e shkencave nuk kishin mjetet e nevojshme për këtë. Ata arritën të botojnë vetëm një vëllim të veprave të Mikluho-Maklait.

Pas mbarimit të luftës së Madhe patriotike 1941-1945 Akademia e Shkencave botoi një përmbledhje prej shumë vëllimesh të veprave të këtij udhëtari.

Kujtimi i Mikluho-Maklait nuk mbeti vetëm në hartë, por edhe në gjuhën e gjallë të banorëve të Guinesë së Re: papuanët thonë edhe sot: «so-patë e Maklait», «shalqi i Maklait» etj.

Gjeografi i ndëgjuar Berg ka shkruar: «Nuk ka dyshim se N.N.Mikluho-Maklai hyn në numrin e studiuesve të shquar dhe origjinalë të jetës së popujve primitivë. Origjinaliteti i Mikluho-Maklait qëndron në dashurinë e tij të zjarrtë jo vetëm për shkencën, por edhe për njerëzimin, në bindjen e tij të patundëshme se të ashtuquajturit njerëz të egër janë njerëz njëjloj si të bardhët dhe në urrejtjen e tij të thellë kundrejt atyre metodave të mashtrimit dhe të dhunës, që përdornin zakonisht europianët, që kishin futur në tropikë për «ëllime fitimi».

## ME TRAP NËPËR OQEANIN PAQËSOR

Kur anijet europiane hodhën për herë të parë ankorat në shkëmbejt koralianë dhe në ishujt vullkanikë të Polinezisë, udhëtarët zbuluan këtu gjurmët e një kulture të vjetër: rrugë të shtruara, piramide me shkallë dhe trupore vigane, të ndërtuara prej blloqesh të mëdha guri.

Mijra kilometra i ndajnë ishujt Samoas prej ishujve Havaj ose prej ishullit të Pashkëve dhe me gjithë këtë kudo banorët flasin në dialektet lokale të së njejtës gjuhë.

Nga kanë ardhur banorët e Polinezisë? Çfarë popujsh kanë populluar ishujt e panumërt, që shtrihen në hapësirat e pafundme të oqeanit Paqësor, larg kontinenteve të banuara? Enigma e origjinës së polinezianëve u dha shkas hipotezave të ndryshme. Disa mendonin se popullsia e Polinezisë e kishte origjinën nga India, Egjipti, Kaukazi, Skandinavia, bile dhe nga Atlantida.<sup>1)</sup>

Disa shkencëtarë mbronin tezën e origjinës amerikane të polinezianëve. Piramidat e shkallëzuara dhe monolite, truporet vigane të ishullit të Pashkëve dhe të ishujve Markize u ngjanin në mënyrë të çuditëshme piramidave dhe sendeve të gdhendura që kishin lënë në malet e bregut të oqeanit Paqësor banorët e vjetër të Perusë.

Kjo hipotezë bëri për vete etnografin e ri norvegjez Tur Hajerdal. Duke studiuar legjendat dhe mitet e polinezianëve, Hajerdali konstatoi se të gjitha legjendat poetike të banorëve të ishujve i

1. Atlantida ose Atllanta — sipas gojdhaneve të vjetra greke është një kontinent i madh në oqeanin Atllantik që është zhdukur pa lënë gjurmë.

janë kushtuar zotit dhe prisit Tiki<sup>r</sup>— birit të Die-llit, i cili dikur kishte lundruar nëpër oqean prej një vendi malor në Lindje.

Hajerдали u muar me studimin e kulturës së lashtë të Amerikës Jugore. Legjendat peruane flasin për një popull që banonte diku nga veriu. Përkishtë këta kishin punuar në male statujet vigane prej guri. Më vonë, pas thyerjes në betejën me inkët në liqenin Titikaka, ky popull tok me prishin e tij Kon-Tiki (që do të thotë «Diell-Tiki») u zhduk pa lënë gjurmë. Kon-Tiki i çoi njerëzit e tij në perëndim përmes oqeanit. Kështu thonin legjendat...

Kur fashistët gjermanë pushtuan Norvegjinë Hajerdali merrej me gërmime në Kolumbi, duke studiuar vizatimet në gurë në stilin polinezian. Nga brigjet plot diell të oqeanit Paqësor shkencëtari-patriot u nis në krahinën tejpolare. Ai u bë luftëtar-parashutist, mori pjesë në beteja të shumta në rrugët kryesore detare, kundër gjermanëve dhe vetëm mbasi u çlirua Norvegjia, Tur Hajerdali u kthye tek studimet e tij.

Hajerдали shkroi një vepër të madhe shkencore që provonte origjinën amerikane të polinezianëve, por në botën shkencore askush nuk i kushtoi vëmendje kësaj vepre. A mund të flitet seriozisht për shpërnguljen e indianëve në ishujt e Polinezisë, duke ditur se ata nuk kishin kurrëfarë anijesh përveç trupave primitivë. Kështuqë Hajerdali mori një vendim të papritur; ai do të provojë vetë se me trap peruan mund të kalohet oqeani Paqësor.

Kështu lindi mendimi për njerën nga eksperimentat më interesante shkencore të kohës sonë. Hajerdali studioi me kujdes rrymat dhe erërat detare. Ai arriti në përfundimin se rryma e Humboldt (ta-

ni rryma e Perusë) si dhe rryma ekuatoriale jugore do ta çonin patjetër trapin nga brigjet e Amerikës Jugore në ishujt e Markizit ose në ishujt Tuamotu. Etnografi i ri kërkoi shënimet e europianëve të parë, që kishin shkuar në brigjet e oqeanit Paqësor. Atje kishte mjaft vizatime dhe përshkrime të trapave të lashtë indianë, të ndërtuara me dru balsi, dru shumë i fortë dhe dy herë më i lehtë se tapa. Hajerdali vendosi të ndërtojë një trap, duke ndjekur pikë për pikë modelet e vjetra: nëntë trarë të trashë, të lidhur me litarë prej fibrash bimore, velë katërkëndshe, një kasollë e vogël — kamare prej bambuje dhe një lopatë drejtuese në pupë-kaq.

Ekipazhi i anijes së jashtëzakonshme u mblodh me shpejtësi. I pari u paraqit inxhinieri Herman Vatsinger. Thirrjes së Hajerdalit iu përgjegj shoku i fëminisë së tij, piktori Erik Heselberg dhe shokët e armëve Knut Haugland dhe Turstein Raabiu. Pesë norvegjezët e rinj kishin besim të madh në suksesin e ekspeditës. Rreziku nuk i frikësonte. Gjatë luftës Tursteni dhe Knuti kishin zbritur shumë herë me parashuta dhe me radica marrëse në prapavijat e armikut, ndërsa Eriku, dikur kishte qenë detar, dinte të përdorte sekstantin aq mirë sa kambalëcin dhe penelin. Pjesëmarrësi i gjashtë i ekspeditës u bë etnografi suedez Bengt Danielson.

Vetë pregatitja e ekspeditës kërkonte guxim, vendosmëri dhe qëndresë nga pjesëmarrësit e saj. Aeroplani i çoi në Kito, kryeqytet i Ekuadorit, prej këtu u nisën në xhungla për të gjetur dru balzi. As gjarpërinjtë helmatus dhe hagrepët, as rreziku i sulmimit nga indianët e egër, as vërshimet e lumëve tropikalë nuk i ndaluan udhëtarët në rrugën




Fig. 10. Trapi «Kon-Tiki» ndërtuar sipas modelit të trapit të vjetër peruan.



e tyre. Në thellësi të pyllit virgjër Hajerdali dhe miqt e tij gjetën drurin që kërkonin.

Trarët e çmueshëm i transportuan me anën e lumit Palenkue dhe Rio Huajas në portin Guajakil dhe prej këndeje në pikën e nisjes së ekspeditës — në Lima. Në skelën Kaliao, u ndërtua trapi — kopie e saktë e anijeve të vjetra peruane, i vetmi ndryshim prej lundëtarëve indianë që se pjesëtarët e ekspeditës muarën me vete një radiostacion. Por si do t'u vinte në ndihmë ky radiostacion udhëtarëve, të humbur në hapësirat e pafundme të oqeanit Paqësor në një trap dhjetë metrash, larg rrugëve detare?

Më 27 prill 1947 u mblodhën shumë njerëz në portin Kaliao për të përcjellur studiuesit guximtarë. Duhet ta themi se asnjëri nuk besonte në suksesin e ekspeditës. Mjaft kishin parashikuar një mbarim të sigurt të saj.

Udhëtarët e rinj punonin pa u turbulluar në punën e tyre. Era mbushte velin katror me figurën mjekroshe të Kon-Tikit — lundëtarit legjendar i cili, sipas supozimit të Hajerdalit, kishte zbuluar Polinezinë rreth vitit 500 të erës së re. Me këtë emër u pagëzua anija e jashtëzakonshme. Dhe ja Kon-Tiki çohet me rimorkiator në detin e hapur. Era e mbarë mori me vete trapin dhe pas pak kohe malet e dhëmbëzuara të Perusë u fshehën pas perdes së reve. Tani kthimi prapa ishte i pamundur. Pasati e çonte trapin nga veriperëndimi. Në mbrëmje oqeani u mbulua prej valëve uluritëse. «Kon-Tiki» ngjitej lehtë mbi malet e ujit edhe atëhere, kur kreshta e valës derdhej në trap, uji dilte menjëherë nga vrimat midis trarëve, si ndërmjet dhëmbëve të pirunit.



Gjatë disa ditëve të para ekipazhi luftoi me tërbim kundër forcave të natyrës. Drejtimi i velit dhe i lopatës drejtuese kërkonte tension shumë të madh të forcave, kështu që udhëtarët u bindën për vetitë e shkëlqyera lundruese të trapit. Kaloi një javë. Valët u qetësuan dhe oqeani ua tregoi bujarisht të fshehtat e tij studiuesve guximtarë. Nuk kalonte ditë pa parë banorët e thellësive të oqeanit. Sardelat, delfinët e shkathtë dhe tonët e majmë ngjiteshin në trap. Tufa peshqish fluturues u kalonin mbi kokë dhe shumë prej tyre binin në trap. Një natë vala hodhi drejt në kamare peshkun gjarpër shumë të rrallë, të cilin gjer atëhere nuk e kishte parë asnjëri të gjallë. Skeletet e këtyre peshqve shiheshin shumë rallë në brigjet e Amerikës.

Natën uji rreth trapit ziente nga shkëlqimet fosforuese. Nganjëherë sytë ndriçues e të rrumbullaktë të një qenieje ngriheshin nga thellësia e detit, të tërhequr nga drita e zbetë e fenerit. Ndoshta ishte ndonjë kolimar i madh, që jeton me shumicë në këta ujra. Paraqitja e tyre ngjallte mjaft frikë, por asnjë nuk u përpoq të ngjitej në trap. Tur Hajerdali dhe shokët e tij konstatuan se këlyshët e kolimarëve hidhen mbi ujë dhe fluturojnë me dhjetra metra në ajër për të shpëtuar nga ndjekësit. Kjo as që i kishte shkuar nëpër mend ndonjë njeriu më parë.

Më 24 maj në drejtim të trapit erdhi një përbindësh vigan i ujrave tropikalë — një peshkaqen — balenë 20 metrash — peshku më i madh që njihet në botë. Peshkaqenët e zakonshëm dukeshin çdo ditë. Nganjëherë bile ata mblidheshin me sasia të mëdha rreth trapit. Dalëngadalë lundëtarët u mësuan me ta dhe gjetën mënyrën për t'i tërhequr këta mishngrënës të tmershëm në trap.

Një herë trapi ndeshi në një tufë balenash. Viganët e detit u sollën për disa orë të qetë rreth detit dhe së fundi u zhdukën në oqeanin e pafund.

Faqet e ditarit të anijes «Kon-Tiki» përmbanin shënime të shumta rreth takimeve me qenie enigmatike deti, që deri atëherë nuk njiheshin. Një raje (peshk) vigane, që qëndronte si shkëmb nën ujor në sipërfaqen e oqeanit, peshq ndriçues, gjarpërues dhe shumë banorë të tjerë të oqeanit, që u panë nga trapi, nuk ishin parë asnjëherë prej shkencëtarëve nga një afërsi kaq e madhe. Këto takime nuk ishin gjithmonë pa rrezik. Për të vërejtur jetën e banorëve të thellësive, Erik Heselbergu përgatiti prej bambuje një kaçile zhytëse. Në të njeriu mund të qëndronte nën ujë i qetë, derisa të kishte frymë. Ky mjet kaq i thjeshtë dha mundësi të bëhen shumë vrojtime interesante.

Javët kalonin. Ato ishin plot punë të parreshtur. Çdonjëri prej udhëtarëve kryente detyrat e tij. Ish radistët ushtarakë Knut-i dhe Turstajn-i shfrytëzonin krejt përvojën e tyre të pasur për ta vënë në veprim aparaturën e radios, që shpesh herë lagej nga uji. Ata merreshin me ditë të tëra me bateritë dhe saldatorët e tyre, ndërsa në darkë përhapnin nëpër eter buletin meteorologjik, që kish rëndësi të madhe për stacionet meteorologjike të Europës dhe Amerikës. Eriku kryente detyrën e timonierit dhe, përveç kësaj, bënte skica. Turi shënonte vrojtimet në ditarin e anijes, zinte peshqe dhe planktone, merrte në film. Bengti kryente detyrën e ekonomatit dhe lexonte libra shkencorë, Hermani bënte vrojtime meteorologjike dhe hidrologjike. Çdo njëri nga këta rrinte katër orë gjatë 24 orëve në timon.

45 ditë pas fillimit të lundrimit udhëtarët u gjendën pikërisht në gjysmën e rrugës së objektivit të tyre — në 108<sup>o</sup> gjatësie perëndimore. Ata ndodheshin më se dy mijë milje larg brigjeve të Amerikës Jugore. Kështu që i prisnin edhe shumë prova të tjera. Në ujrat e Polinezisë u derdhën mbi trap njëra pas tjetrës tri valë shumë të mëdhaja, sigurisht, nga tërmete nëntokësore. «Kon-Tiki» i përballoi edhe këto goditje. Dhe pas dy ditësh filloi një stuhi e tmerrshme, që vazhdoi për disa ditë me radhë. Por udhëtarët ishin mësuar të luftonin me valët. Lidhja e ngushtë miqësore i ndihmoi në rrethanat më të vështira, nganjëherë bile tragjike. Në kohën kur Hermani u ndodh jashtë trapit dhe kur rryma po e largonte gjithënjë më shumë prej tij, Knuti pa u menduar gjatë, duke vënë jetën në rrezik, u hodh në valë dhe shpëtoi shokun. Gjashtë shkencëtarët e rinj nuk e humbën kurrë besimin në suksesin e ndërmarrjes së tyre të guximshme. Gëzimi ishte shok i pandarë i tyre. Kitara, shakatë zbavitëse, ndjenja e humorit i ndihmuan në luftën e ashpër dhe të parreshtur kundër forcave të natyrës.

Dhe ja njerëzit dolën më të fortë se oqeani.

Më 30 qershor u duk në horizont toka. Ishte ishulli Pukapuha, pikë ekstreme e arqipelagut Tuamotu. Rryma nuk e la trapin t'i afrohet ishullit. Pastaj u duk ishulli Angatau, por tek ky nuk ishte e mundur të afroheshin.

Ishin mbushur 97 ditë udhëtim. Detyra ishte kryer. Njerëzit kishin çarë me trap oqeanin Paqësor dhe kishin arritur në ishujt e Polinezisë. Mbetej edhe një provë — të kalohej nëpër barierën e shkëmbjeve koraliane tek të cilët sigurisht, ishin shkaktërruar shumë anije. Gjëja më e keqe do t'ishte

vdekja në mbarim të udhëtimit. Por dhe këtu gjashtë udhëtarët treguan po atë fuqi [shpirtërore, shpirtin e organizimit dhe të guximit, që i kishte ndihmuar gjatë tërë lundrimit të pashembëllt.

Më 7 gusht «Kon-Tiki» u hodh nga dallga në një shkëmb koralian, pikërisht në bregun e ishullit të pabanuar, të mbuluar me palma Raroia. Kjo ishte toka e parë, në të cilën shkelën gjashtë detarët. Pas disa ditësh këtu erdhën me lundrat e tyre disa banorë të ishujve të Polinezisë. Ata i pritën udhëtarët me gëzimin më të madh. Mbas një farë kohe, për ekipazhin e «Kon-Tikit», erdhi nga ishulli Taiti anija frënge «Tamara».

Kështu mori fund kjo ekspeditë e shquar. Tani Tur Hajerdali mund të shpresonte në vemendjen e botës shkencore. Veprën e tij e botuan. Në të paraqiten shumë prova interesante të lidhjes historike të Polinezisë me Amerikën Jugore. E me gjithë këtë, siç e pranon edhe vetë autori, me udhëtimin e tij ai provoi vetëm vetitë e larta për lundrim të trapave prej balzi.

Mbrojtësit e hipotezës së origjinës aziatike të polinezianëve vazhdojnë të ndjekin pikëpamjen e tyre. Në këtë mënyrë, çështja e origjinës së polinezianëve mbetet gjithënjë e hapur. Por udhëtimi i Hajerdalit dhe shokëve të tij provoi në mënyrë bindëse se peruanët e vjetër kanë mundur të shkojnë në ishujt e Polinezisë.

Kjo ekspeditë është përshkruar me talent prej vetë Hajerdalit në librin e tij «Udhëtimi me Kon-Tiki», që është bërë shumë herë në gjuhë të ndryshme.

Tur Hajerdali me shokët e tij udhëtuan me trap prej nëntë trarësh 4300 milje detare (rreth 8000 kilometra). Kjo largësi është dy herë më e

gjatë se rruga që bëri Kolombi me karavelat e tij gjatë udhëtimit të parë në Indinë Perëndimore. Dhe pavarësisht, si do ta zgjidhin studiuesit e ardhshëm çështjen e origjinës së polinezianëve, udhëtimi në «Kon-Tiki» do të mbetet në historinë e shek. XX shembëll heroizmi shkencor vetmohues.

ALFABETI

Page

7  
14  
18  
23  
27  
33  
37  
40  
44  
54  
61  
68  
77

1	Marco Polo
2	Marco Polo i Kolombit
3	Rruga detare për Indi
4	Siç ka qendruar me Amerikën
5	Lundrum i parë në Indi
6	Zbulimi i Amerikës
7	Lundrumet e Xhuanes Kolumit
8	Udhëtimi i parë gjatë udhëtimit të parë
9	Udhëtimi i parë gjatë udhëtimit të parë
10	Udhëtimi i parë gjatë udhëtimit të parë
11	Udhëtimi i parë gjatë udhëtimit të parë
12	Udhëtimi i parë gjatë udhëtimit të parë